Instituti Gjyqësor i Kosovës
Kosovski Institut za Pravosudje
Kosovo Judicial Institute

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova/Republic of Kosovo**
*Instituti Gjyqësor i Kosovës/Kosovski Institut za Pravosudje/Kosovo Judicial Institute*



# RAPORTI VJETOR

# 2011

## Tabela e përmbajtjes


1. Përmbledhje ekzekutive ........ 5
2. Letër nga Kryetari i Këshillit Drejtues ........ 7
3. Deklarata e Misionit ........ 8
4. Rreth IGJK-së ........ 8
5. Organet drejtuese të IGJK-së ........ 8
6. Struktura e brendshme organizative e IGJK-së ........ 9
7. Qëllimet dhe objektivat kryesore të IGJK-së për 2011 ........ 10
8. Sfidat që shoqëruan IGJK-në gjatë vitit 2011 ........ 11
9. Programet e IGJK-së ........ 11
10. Programi i Vazhdueshëm për Arsimim Ligjor (PVAL) ........ 12

10.1. Aktivitetet trajnuese të PVAL ........ 13
10.2. Pjesëmarrja në trajnimet e PVAL ........ 14
10.3. Pjesëmarrja sipas përkatësisë gjinore ........ 15
10.4. Pjesëmarrja dhe numri i trajnimeve në baza mujore ........ 15
10.5. Trajnimet e PVAL sipas lëmive dhe temave ........ 16

10.5.1. Trajnimet nga Lëmia Penale ........ 16
10.5.2. Trajnimet në Lëmin Civile, Administrative dhe të Punës ........ 18
10.5.3. Trajnimet nga Lëmia e Kundërvajtjeve ........ 18
10.5.4. Kodi i Etikës dhe Sjelljes Profesionale ........ 19
10.5.5. Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut ... 19
10.5.6. E Drejta e Bashkimit Evropian (*Acquis Communitaire)* ........ 19

10.6. Trajnime të specializuara në PVAL ........ 20

10.6.1. Ndërtimi i shkathtësive të përfaqësimi gjatë gjykimit ........ 20
10.6.2. Ligji për mbrojtjen e ambientit ........ 20
10.6.3. Trajnimet nga të drejtat e njeriut dhe barazia gjinore ........ 20
10.6.4. Organizimi i Gjykatave sipas Ligjit për Gjykata ........ 20

10.6.5. Ligji për Prokurorin e Shtetit ..... 21
11. Programi Fillestar për Arsimim Ligjor (PFAL) ..... 21
11.1. Trajnimet e PFAL (gjenerata e tretë) ..... 22
11.1.1. Faza e parë ..... 22
11.1.2. Faza e dytë ..... 23
11.1.3. Organizimi, hartimi dhe zbatimi i provimeve në kuadër të PFAL ..... 25
11.1.4. Faza e tretë ..... 26
11.2. Vizita e kandidatëve në Akademinë Gjyqësore të Turqisë ..... 26
11.3. Ceremonia e diplomimit ..... 27
11.4. Trajnimet e PFAL (gjenerata e katërt) ..... 27
11.5. Provimi Përgatitor/Hyrës për gjeneratën e katërt të PFAL ..... 28
11.6. Ceremonia e fillimit të PFAL IV ..... 29
11.7. Trajnimet në PFAL IV ..... 30
11.7.1. Faza e parë ..... 30
11.7.2. Faza e dytë ..... 30
11.7.3. Faza e tretë ..... 30
11.8. Aktivitetet shtesë të kandidatëve të PFAL ..... 32
12. Programi i trajnimit për avancim (PTA) ..... 32
12.1. Pjesëmarrja në trajnime në Programin e Trajnimeve për Avancim ..... 34
12.2. Pjesëmarrja dhe numri i trajnimeve në baza mujore në kuadër të PTA ..... 35
12.3. Trajnimi i gjyqtarëve porotë ..... 35
12.4. Trajnimi i profesionistëve tjerë nga lëmi i gjyqësisë ..... 36
13. Konferencat ..... 38
13.1. Konferenca Vjetore për Gjyqësorin e Kosovës ..... 38
13.2. Konferenca vjetore e “Drejtësisë për të Mitur” ..... 38
13.3. Konferenca e parë vjetore e të diplomuarve në IGJK ..... 38
13.4. Trajnimi i Trajnuesve ..... 39
14. Administrata dhe Financat ..... 40
14.1. Administrata ..... 40
14.2. Trajnimi i stafit të IGJK-së ..... 41
14.3. Prokurimi ..... 42
14.4. Financat ..... 42
14.5. Mbështetja financiare nga Donatorët ..... 47
14.6. Bashkëpunimi me donatorë ..... 49

15. Publikimet e IGJK-së ........ 53
16. Mësimi në distancë / e - learning ........ 54
17. Bashkëpunimi Ndërkombëtar dhe Vizitat Studimore ........ 55
17.1. Shkolla Kombëtare e Magjistraturës në Bordo të Francës ........ 55
17.2. Akademia Gjyqësore e Gjermanisë dhe Akademia Evropiane e Drejtësisë në Trier 56
17.3. Konferencë ndërkombëtare - "Gjyqtari/Prokurori Vendor dhe Evropian - Roli i Qendrave për Trajnim Profesional" ........ 56
17.4. Punëtori Regjionale për Trajnime Gjyqësore *"Bashkëpunimi Regjional në të Drejtën Penale-Ngritja e kapaciteteve për luftimin e krimeve kibernetikë"* ........ 57
17.5. Vizita në Shkollën e Magjistraturës së Republikës së Shqipërisë ........ 57
17.6. Konferenca e 5-të Ndërkombëtare për Trajnime Gjyqësore *Tema:"Trajnimi gjyqësor në botën e globalizuar-rikthimi i besimit dhe stabilitetit"* ........ 57
17.7. Konferenca Regjionale "E ardhmja e trajnimit fillestar dhe të vazhdueshëm për gjyqtarët dhe prokurorët e rinj - Situata aktuale, perspektiva në të ardhmen dhe objektivat" ........ 57
17.8. Vizita studimore në Tribunalin Ndërkombëtar në Hagë (ICTY) ........ 58
18. Programi për praktikant-studentë të Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës ........ 58
19. Anekset ........ 59
19.1. Aneksi I – Aktivitetet trajnuese - PVAL Janar - Dhjetor 2011 ........ 59
19.2. Aneksi III – Aktivitetet e realizuara në PTA - 2011 ........ 62
19.3. Aneksi IV – Aktivitetet e realizuara për gjyqtarët porotë - 2011 ........ 63
19.4. Aneksi V – Aktivitetet e realizuara për profesionist tjerë në sistemin e drejtësisë - 2011 ........ 63
19.5. Aneksi VI – Modulet trajnuese të realizuara me kandidatët për gjyqtarë dhe prokurorë gjatë vitit 2011 ........ 64
20. Lista e shkurtesave ........ 66

# 1. Përmbledhje ekzekutive

Në këtë raport janë pasqyruar të gjitha aktivitetet dhe të arriturat e Institutit Gjyqësor të Kosovës (IGJK) gjatë vitit 2011. Gjatë kësaj periudhe IGJK ishte përqendruar në ngritjen e kapaciteteve të sistemit gjyqësor dhe prokurorial në Kosovë, përmes programeve të ndryshme për arsimim ligjor. Përmbajtja e këtyre programeve ishte gjithëpërfshirëse dhe në mbështetje të nevojave të gjyqtarëve dhe prokurorëve, kandidatëve për gjyqtarë dhe prokurorë si dhe profesionistëve tjerë nga lëmi i gjyqësisë e prokurorisë të identifikuar nga IGJK.

Edhe gjatë vitit 2011 u vazhdua me zbatimin e programeve të ndryshme për arsimim ligjor. Programi i Trajnimeve të Vazhdueshme (PVAL), ka shënuar një të arritur të çmuar duke përfshirë organizimin e 78 aktiviteteve. Këto trajnime u organizuan nga lëmia penale, drejtësia për të mitur, civile, komerciale, administrative, dhe e punës. Në kuadër të këtyre aktivitete ishin përfshirë për trajtim tema e module të llojllojshme të karakterit të përgjithshëm dhe të nivelit të specializuar. Metodologjia e aplikuar për realizim të shumicës së këtyre aktiviteteve bazohej në konceptin “mëso duke bërë”.

Në përgjigje të nevojave për plotësimin e vendeve të lira për gjyqtarë e prokurorë, IGJK organizojë për herë të katërt Provimin Përgatitor/Hyrës për kandidatët potencial për gjyqtarë e prokurorë. Këto zhvillime shënuan fillimin e trajnimeve të PFAL edhe për 56 kandidatë. Kështu filloj trajnimi i gjeneratës së katërt të kandidatëve për gjyqtarë e prokurorë edhe përkundër faktit se IGJK kishte në trajnim 32 kandidatë nga gjenerata e tretë të cilët kishin filluar trajnimet një vit më parë. Këto ngjarje sfiduan kapacitetet menaxhuese, profesionale, administrative e financiare të IGJK-së ngase agjenda e aktiviteteve të PFAL përfshinte 6 ditë të javës (përfshirë të shtunën). Kjo sfidë përfshinte trajnimin e 88 kandidatëve nga maji deri në tetor 2011, kur diplomoi gjenerata e tretë (32 kandidatë). Megjithatë 56 kandidatë ende ishin në trajnim.

Programi i Trajnimeve për Avancim kishte shënuar organizimin e 13 moduleve të specializuara, përmes 19 ditë trajnimi, ku janë përfshirë gjyqtarët dhe prokurorët e sapo emëruar. Gjatë periudhës raportuese ka vazhduar organizimi i trajnimeve edhe për gjyqtarët porotë, ndërsa trajnimi për stafin e gjykatave dhe prokurorive ka shënuar një ngritje të mbështetjes për ta. Me mbështetjen e Programit të Binjakëzimit është funksionalizuar platforma e mësimit në distancë (e-learning), është punuar në fushën e publikimeve me ç’rast janë realizuar publikuar module, doracakë, revista, buletine dhe broshura. Gjithashtu janë realizuar programe të ndryshme jashtë vendit (vizita studimore, trajnime) dhe është shënuar pjesëmarrje aktive në konferenca e takime regjionale e ndërkombëtare që kishin në fokus arsimimin ligjor për gjyqtarë, prokurorë dhe profesionist tjerë nga lëmi i gjyqësisë.

Gjatë vitit 2011, në mbështetje të vazhdueshme nga partnerë të shumtë ndërkombëtarë, IGJK ka zbatuar programe speciale trajnimi, trajnime të trajnuesve dhe ngritje të kapaciteteve të stafit.

Në periudhën raportuese ka shënuar suksese në të gjitha aktivitetet e tij edhe Departamenti i Administratës dhe Financave i IGJK-së. Sfidat e krijuara si rezultat i rritjes së numrit të kandidatëve të PFAL, u shprehën sidomos në buxhetin e IGJK-së i cili duke qenë i pamjaftueshëm kishte limituar edhe numrin e stafit. Megjithatë me mbështetje të donatorëve

dhe Ministrisë së Drejtësisë, u arrit që të tejkalohet minimumi i shpenzimeve të krijuara për shërbimet e trajnimit dhe pagesën e honorarit të kandidatëve të PFAL.

Pavarësisht sfidave të hasura në zbatimin e aktiviteteve të tij, perspektivat për ngritje profesionale do të vazhdojnë të kenë përkushtimin më të lartë të IGJK-së.

## 2. Letër nga Kryetari i Këshillit Drejtues



Ky ishte një vit me të arritura të shumta për IGJK-në. Edhe një herë një përqendrim qenësor ishte në zgjerimin e aktiviteteve në kuadër të programeve për arsimim ligjor të Institutit. Të gjitha programet trajnuese të përfshira në mandatin ligjor ishin zbatuar tërësisht.

Programi i trajnimeve të vazhdueshme ishte azhurnuar me trajnime të reja nga lëmia penale, siç janë trajnimet për zbatim efektiv të procedurave penale dhe ato për diskutim të sfidave të cilat janë pjesë e shumë rasteve praktike si; krimi i organizuar, korrupsioni, krimi kibernetik, mënyra e trajtimit të dëshmitarëve dhe dëshmitarët e mbrojtur, aspektet e mbrojtjes nga dhuna në familje etj. Ndërsa në fushën civile ishte përfshirë; trajtimi i ligjeve të reja apo risive në ndryshimet e ligjeve në fuqi, institute të veçanta të procedurës kontestimore, pronësore, komerciale, trashëgimore, të drejtës së punës, administrative dhe zgjidhja alternative e rasteve.

Gjatë punës sonë, ne kemi zhvilluar raporte të forta bashkëpunimi me institucionet vendore e ndërkombëtare duke krijuar aleanca të fuqishme mbështetjeje dhe duke punuar së bashku për të arritur ato që janë prezantuar në këtë raport vjetor.

Gjatë vitit 2011 IGJK ka hartuar edhe një plan pune për vitin 2012 dhe mbi bazë të Platformës Strategjike të miratuar nga Këshilli i tij Drejtues ka filluar hartimin e Planit Strategjik për periudhën 2012-2015.

Puna e bërë nga IGJK gjatë vitit 2011 do të ndihmojë punën e gjyqtarëve dhe prokurorëve të cilët veprojnë në një ambient me ndryshime të shumta e të shpeshta ligjore e sociale, do të ngritë kapacitetet profesionale të kandidatëve për këto pozita si dhe ka shënuar përpjekje serioze për të mbështetur edhe gjyqtarët porotë dhe profesionistët tjerë në lëmin e gjyqësisë dhe prokurorisë.

Nuk do të ishte e mundur që IGJK të ofronte këtë rang të programeve nëse nuk do të ishte mbështetja e anëtarëve të sistemit gjyqësor e prokurorial, gatishmëria, kreativiteti dhe puna e madhe e të cilëve është reflektuar në të gjitha programet për arsimim ligjor të IGJK-së të cilat po i bëjmë publike në këtë raport. Falënderimet i përkasin edhe komunitetit të shumë donatorëve për ndihmën e vazhdueshme financiare dhe ekspertizës së ofruar për IGJK-në.

Përfundimisht falënderoj, anëtarët e Këshillit Drejtues dhe stafin e Institutit duke njohur dhe vlerësuar lartë rolin e tyre, përkushtimin e vazhdueshëm dhe punën profesionale në suksesin e Institutit gjatë vitit 2011.

Me nderime,

Dr.Sc. Fejzullah Hasani

Kryetar i Gjykatës Supreme
Kryetar i Këshillit Drejtues i Institutit Gjyqësor të Kosovës

## 3. Deklarata e Misionit

IGJK është një institucion që ka në vete një ekip të përkushtuar të profesionistëve, të cilët besojnë se promovimi i shkathtësive profesionale dhe etike është një komponentë kritike e profesionalizmit ligjor të gjyqtarëve, prokurorëve, kandidatëve për këto pozita si dhe profesionistëve tjerë të sistemit gjyqësor e prokurorial të Kosovës.

Misioni i IGJK-së është që të:

- Promovojë ngritjen e vazhdueshme profesionale të gjyqtarëve dhe prokurorëve në detyrë dhe atyre të sapoemëruar;
- Mbështesë procese rekrutimi të barabartë dhe transparente për të gjithë kandidatët për gjyqtarë dhe prokurorë;
- Krijojë dhe ngritë kualitetin më të lartë profesional dhe etik të kandidatëve për gjyqtarë dhe prokurorë;
- Ngritë dhe zhvillojë kapacitetet administrative të stafit të gjykatave dhe prokurorive.

## 4. Rreth IGJK-së

IGJK është institucioni udhëheqës kryesor përgjegjës për trajnimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në detyrë, organizimin e provimit përgatitorë dhe përgatitjen profesionale të kandidatëve për gjyqtarë dhe prokurorë, si dhe trajnimin e profesionistëve tjerë në kuadër të sistemit gjyqësor e prokurorial të Kosovës, të identifikuar nga IGJK (Ligji nr. 02/L-25).

IGJK filloj promovimin e arsimimit ligjorë me një standard dhe metodologji profesionale tash e 11 vite më parë dhe tani është ngritur dhe mbetet standardi kryesor i zhvillimit profesional. Derisa profesioni ligjorë në Kosovë ka pësuar shumë ndryshime gjatë kësaj kohe, metoda e të mësuarit e aplikuar nga IGJK mbetet mënyra më efektive për ngritjen e kapaciteteve profesionale të sistemit gjyqësor e prokurorial.

## 5. Organet drejtuese të IGJK-së

Bazuar në ligjin për themelimin e tij, organet më të larta drejtuese të IGJK-së janë, Këshilli Drejtues dhe Drejtori.

Këshilli Drejtues i IGJK-së gjatë vitit 2011 ka mbajtur pesë takime të rregullta, në të cilat ka miratuar dhe ka marrë vendime lidhur me:

- Raportin vjetor të punës për vitin 2011;
- Platformën Strategjike për Reformimin dhe Zhvillimin e IGJK-së;
- Përbërjen e Komisionit për Hartimin dhe Vlerësimin e Provimit Përgatitor/ Hyrës;
- Përbërjen e Komisionit për Hartimin e akteve nënligjore të IGJK-së;
- Kërkesën Buxhetore të IGJK-së për vitin 2012;
- Plani Vjetor të Punës për vitin 2012.

Një organ specifik i IGJK-së, i themeluar me statut, është Këshilli Programor i cili është organ ndihmës i Këshillit Drejtues[1]. Gjatë vitit 2011 Këshilli Programor ka mbajtur disa takime në të cilat, ndër të tjera ka diskutuar dhe vendosur lidhur me:

- Mbarëvajtjen e PVAL PFAL dhe PTA;
- Rregullat e Provimit Përgatitor/Hyrës, për vitin 2011;
- Strukturën e Provimit Përgatitor/Hyrës, për vitin 2011;
- Trajnuesit e IGJK-së;
- Planin e Punës për 2012 (programet trajnuese);

## 6. Struktura e brendshme organizative e IGJK-së

IGJK zhvillon mandatin e tij bazuar në Departamentin e Programeve dhe në Departamentin e Administratës dhe Financave. Departamenti i Programeve përfshinë pozitat dhe njësitë të cilat udhëhiqen nga Koordinatori i Programit dhe është përgjegjës për:

- Identifikimin dhe zhvillimin i metodave për vlerësimin e nevojave trajnuese dhe metodologjisë së organizimit të trajnimeve në kuadër të programeve të ndryshme trajnuese;
- Përgatitjen e politikave dhe strategjive trajnuese lidhur me nevojat për trajnime;
- Organizimin e trajnimeve për gjyqtarët dhe prokurorët aktual;
- Organizimin dhe Vlerësimi i Provimit Përgatitor/Hyrës;
- Organizimin e trajnimeve për kandidatët për gjyqtarë dhe prokurorë;
- Organizimin e trajnimeve për avancim të gjyqtarëve dhe prokurorëve;
- Organizimin e trajnimeve për gjyqtarët porotë dhe profesionistë të tjerë në gjyqësi;
- Organizimin e trajnimeve për trajnues;
- Raportimin dhe mbajtjen e evidencës së të dhënave për aktivitete të ndryshme trajnuese; etj.

Departamenti i Administratës dhe Financave udhëhiqet nga Drejtori Administrativ Financiar dhe përfshinë sektorë të cilët janë përgjegjës për sigurimin e shërbimeve administrative e financiare të IGJK-së në funksion të realizimit të objektivave programore.
Të gjithë të punësuarit (22) në IGJK janë kategorizuar si shërbyes civil dhe i nënshtrohen rregullave për shërbyesit civil.

[1]Për më tepër shiko Statutin e IGJK-së në http://igjk.rks-gov.net




Organogrami i IGJK-së

## 7. Qëllimet dhe objektivat kryesore të IGJK-së për 2011

Qëllimet dhe objektivat kryesore të IGJK-së për vitin 2011 ishin fokusuar në:

- Inkurajimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve që të jenë efektiv, etik dhe profesional;
- Mbështetjen e një procesi rekrutimi të barabartë dhe transparent për të gjithë kandidatët për gjyqtarë dhe prokurorë;
- Krijimin dhe promovimin e kualitetit më të lartë profesional dhe etik të kandidatëve për gjyqtarë dhe prokurorë;
- Zbatimin e trajnimeve të specializuara për gjyqtarë dhe prokurorë të sapo emëruar;
- Mbështetjen e sistemit gjyqësor e prokurorial në ofrimin e shërbimeve administrative etike dhe efektive;
- Hulumtime dhe publikime të ndryshme nga lëmi i gjyqësisë e prokurorisë;
- Aplikimin e metodologjisë moderne gjatë hartimit dhe zbatimit të programeve për arsimim ligjor;
- Pjesëmarrjen në aktivitete të ndryshme për arsimim ligjor të karakterit ndërkombëtarë.

- Ngritjen e kapaciteteve vendore në aplikimin efektiv të mekanizmave për zgjidhje alternative të rasteve;
- Inkurajimin, mbështetjen dhe ndihmën e programeve për sigurimin e qasjes së barabartë në shërbimet e drejtësisë.

## 8. Sfidat që shoqëruan IGJK-në gjatë vitit 2011

Në realizimin e objektivave gjatë vitit 2011, ndër sfidat kryesore për IGJK-në ishin:

- Organizimi i Provimit Përgatitor/Hyrës në mes të procesit të emërimit;
- Trajnimet e zhvilluara njëkohësisht për dy gjenerata të kandidatëve për gjyqtarë dhe prokurorë (88 kandidatë) dhe atë gjashtë ditë në javë;
- Procesi i emërimit të kandidatëve të dy gjeneratave (III dhe IV);
- Koordinimi dhe mbështetja nga institucionet vendore dhe ndërkombëtare;
- Zbatimi i programeve që mbështesin reformimin e sistemit gjyqësor e prokurorial;
- Zbatimi i të gjitha programeve trajnuese në kohën e reformimit të sistemit gjyqësor dhe prokurorial;
- Koordinimi i pjesëmarrjes në trajnimet e vazhdueshme jo obligative;
- Buxheti dhe stafi i pamjaftueshëm për realizim të një vizioni modern;
- Organizimi i trajnimeve të specializuara
- Fillimi i zbatimit të platformës së mësimit në distancë
- Fleksibiliteti/ndryshimet ligjore/reforma
- Koordinimi i mbështetjes nga donatorët dhe politikat e ndryshme të tyre;
- Procesi i përgatitjeve për fillimin e zbatimit të ligjeve sistemore për sistemin gjyqësor dhe prokurorial;
- Hartimi i programeve trajnuese sipas nevojave për mbështetje të një sistemi të riorganizuar gjyqësor dhe prokurorial;

Këto sfida IGJK i ka tejkaluar falë angazhimit maksimal dhe profesionalizmit të treguar si nga ana e menaxhmentit ashtu edhe e stafit, në përmbushje të përgjegjësive të punës.

## 9. Programet e IGJK-së

Mandati ligjor i IGJK-së, gjatë vitit 2011 është realizuar përmes programeve dhe aktiviteteve kryesore trajnuese si në vijim:

- Programi i Vazhdueshëm për Arsimim Ligjor;
- Provimi Përgatitor/Hyrës për kandidatët për gjyqtarë dhe prokurorë;
- Programi Fillestar për Arsimim Ligjor;
- Programi i Trajnimit për Avancim,Gjyqtarë Porotë dhe Profesionistë në Gjyqësi;
- Programi për Hulumtime dhe Publikime;
- Programi për Trajnimin e Trajnuesve.




**Grafikoni 1. Aktivitetet e realizuara nga IGJK në vitin 2011**

## 10. Programi i Vazhdueshëm për Arsimim Ligjor (PVAL)

Programi i Vazhdueshëm për Arsimim Ligjor (PVAL) iu dedikohet gjyqtarëve dhe prokurorëve të cilët ushtrojnë funksionin e tyre në sistemin gjyqësor e prokurorial të Kosovës. Në përmbushje të nevojave dhe pritjeve për një sistem gjyqësor e prokurorial me integritet të lartë profesional, etik, të paanshëm, të pavarur dhe modern, PVAL përfshin në vete këto objektiva:

- Arsimim Ligjor për gjyqtarët dhe prokurorët lidhur me reformat legjislative si dhe zhvillimet në praktikën gjyqësore**;**
- Ofrimi i mbështetjes profesionale gjyqtarëve dhe prokurorëve në punën e tyre praktike edhe atëherë kur ata lëvizin në pozita të ndryshme;
- Përgatitja e gjyqtarëve dhe prokurorëve për pozitat menaxhuese dhe promovimi i një kulture për menaxhim të mirë të rasteve;
- Nxitja e shkëmbimit të njohurive, metodave dhe praktikave të mira profesionale;
- Forcimi i shkathtësive profesionale të shkrimit, arsyetimit dhe argumentimit gjatë zbatimit të ligjit në praktikë;
- Dhënia e kontributit për mbajtjen e gjyqtarëve dhe prokurorëve të informuar për zhvillimet në lëmin ekonomik, social dhe kulturorë;
- Ngritja e njohurive të gjyqtarëve dhe prokurorëve rreth të drejtës ndërkombëtare në veçanti të Drejtës Evropiane;
- Unifikimi i zgjidhjeve ligjore të rasteve praktike në gjithë sistemin gjyqësor dhe prokurorial të Kosovës; dhe
- Aplikimin e teknologjisë informative për arsimimin ligjor;

Trajnimet e PVAL janë realizuar përmes formave të ndryshme si: seminare, tryeza të diskutimeve, tryeza pune, simulime të gjykimeve dhe konferenca. Këto forma të trajnimeve kanë qenë të karakterit të centralizuar edhe regjional. Një numër i aktiviteteve trajnuese të PVAL janë realizuar në mbështetje nga partnerë ndërkombëtar të cilët kanë ndihmuar IGJK-në në zhvillimin e disa programeve trajnuese.

Në trajnimet e organizuara në kuadër të PVAL, brenda vitit 2011, janë përfshirë aspektet teorike dhe praktike nga:

- E drejta Penale (materiale dhe procedurale);
- Drejtësia për të Mitur;
- Ekzekutimi i sanksioneve penale;
- E drejta Civile (materiale dhe procedurale);
- E drejta Tregtare;
- E drejta Administrative dhe e punës;
- E drejta Evropiane;
- Konventa Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut,
- Etika dhe Sjellja Profesionale;
- Lëmia e Kundërvajtjeve;
- Nga fusha të caktuara të ligjit (kurse të specializuara të përmbledhura në formë të moduleve trajnuese);
- Zhvillimit të shkathtësive të veçanta të gjyqtarëve dhe prokurorëve (menaxhimi i rasteve, shkathtësitë e përfaqësimit gjatë gjykimit etj);
- Trajnimi i Profesionistëve në Gjyqësi dhe Prokurori;

## 10.1. Aktivitetet trajnuese të PVAL

Në vitin 2011 në kuadër të Programit të Vazhdueshëm për Arsimi Ligjor, janë realizuar gjithsej 78 aktivitete trajnuese. Trajnimet e realizuara në numër sipas fushave të së drejtës janë:

- 20 sesione trajnim në lëmin penale;
- 22 sesione trajnim në lëmin civile, administrative e kushtetuese;
- 10 sesione trajnimi nga Drejtësia për të Mitur;
- 2 sesione trajnimi nga lëmia kundërvajtëse;
- 3 sesione trajnimi për Konventën Evropiane për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut;
- 3 sesione trajnimi për Kodin e Etikës dhe Sjelljes Profesionale;
- 6 sesione trajnimi nga e Drejta e BE-së;
- 12 trajnime të specializuara.

Kohëzgjatja e realizimit të një aktiviteti në PVAL varet nga natyra dhe përmbajtja e tij. Mbështetur në këtë frymë trajnimet e këtij programi ishin një ditore, dy ditore, tre ditore, katër ditore dhe pesë ditore.




Grafikoni 2. Trajnimet e organizuara nga IGJK dhe donatorët

## 10.2. Pjesëmarrja në trajnimet e PVAL

Në kuadër të PVAL gjatë këtij viti numri i përgjithshëm i pjesëmarrësve ishte 1273. Prej tyre 992 ishin gjyqtarë, 115 prokurorë, 166 pjesëmarrës tjerë (staf administrativ i gjykatave dhe prokurorive, zyrtarë policor, zyrtarë nga shërbimi sprovues dhe qendrat për punë sociale). Në vijim mund të gjeni numrin e pjesëmarrësve sipas kategorive.

**Pjesëmarrja në trajnimet e realizuara në PVAL 2011**




Grafikoni 3. Pjesëmarrja në trajnimet e realizuara nga PVAL në vitin 2011

## 10.3. Pjesëmarrja sipas përkatësisë gjinore

Në vitin 2011, nga numri i përgjithshëm i pjesëmarrësve, 357 ishin të gjinisë femërore dhe 916 të gjinisë mashkullore (grafikoni nr. 5).




Grafikoni 5. Pjesëmarrja gjinore në trajnimet e PVAL

## 10.4. Pjesëmarrja dhe numri i trajnimeve në baza mujore

Në grafikonin e mposhtëm (6) në mënyrë të detajuar po pasqyrojmë numrin e trajnimeve në PVAL gjatë secilit muaj të vitit 2011.

**Numri i trajnimeve të realizuara në baza mujore në PVAL 2011**




Grafikoni 6. Numri i trajnimeve në baza mujore

## 10.5. Trajnimet e PVAL sipas lëmive dhe temave

### 10.5.1. Trajnimet nga Lëmia Penale



Gjatë vitit 2011, IGJK në bashkëpunim me partnerët e tij ka realizuar 20 aktivitete nga lëmia penale. Në kuadër të këtyre aktiviteteve janë trajtuar çështjet që kanë të bëjnë me Kodin Penal të Kosovës, Kodin e Procedurës Penale të Kosovës dhe Kodin e Drejtësisë për të Mitur.

Foto 1. Trajnimi në IGJK

- Kodi **Penal i Kosovës (KPK):** Në këtë kuadër janë realizuar 9 trajnime me temat: Trafikimi me narkotikë të rrezikshëm dhe substanca të rrezikshme, trafikimi me qenie njerëzore, praktika e dënimeve, ndjekja e krimeve të urrejtjes, korrupsioni, krimi financiar dhe ekonomia joformale, lufta kundër krimit kibernetikë, Ligji penal ndërkombëtarë me fokus në krimet e luftës dhe llojet e përgjegjësive në këto raste.

Qëllimi i organizimit të këtyre temave ishte ngritja e kapaciteteve të gjyqtarëve dhe prokurorëve në:

- luftimin e krimit të organizuar, kualifikimin adekuat të veprave penale, interpretim dhe zbatim të dispozitave ligjore adekuate;
- zbatimin e teknikave hetuese, administrimin e provave adekuate dhe analizimin ligjorë gjatë zhvillimit të procedurave penale në raste konkrete;
- diskutimi i elementeve të veprave penale trafikimi me njerëz, kontrabandimi me migrantë, trafikimi me narkotikë dhe substanca psikotrope;
- njohja me teknikat adekuate për të luftuar krimet kibernetike dhe veprat penale të korrupsionit;

- **Kodi i Procedurës Penale i Kosovës (KPPK):** Temat e përfshira për trajtim në kuadër të KPPK-së ishin të llojllojshme dhe të lidhura drejtpërdrejt me dilemat dhe problemet drejtpërdrejt nga praktika gjyqësore dhe e prokurorisë.

Organizimi i trajnimeve lidhur me temat si: autorizimet e prokurorit publik, fillimi dhe kohëzgjatja e hetimit, masat e fshehta dhe teknike të hetimit dhe vëzhgimit, marrëveshja për pranimin e fajësisë dhe pranimi i fajësisë si dhe shkathtësitë e përfaqësimit gjatë gjykimit, kishin për qëllim të bëjë:

- ngritjen e kapaciteteve për hetimin adekuat, udhëheqjen e rasteve dhe gjykimin adekuat;
- zbatimin praktik të marrëveshjes për pranimin e fajësisë, masat e sigurimit të pranisë së të pandehurit në procedurë;

- avancimin e shkathtësive lidhur me prezantimin e rasteve në gjykim dhe administrimin e provave;

Ndërsa spektri i aktiviteteve lidhur me temat si: paraburgimi, konfirmimi i aktakuzës, dëshmitarët në procedurë penale, dëshmitarët e mbrojtur, konfiskimi i pasurisë të fituar me vepër penale, procedura e shkurtër, shqyrtimi gjyqësor, praktika e dënimeve, ndjekja e krimeve të urrejtës, ndërmjetësimi, ligji penal ndërkombëtarë me fokus në llojet e përgjegjësive tek krimet e luftës, kishte për qëllim:

- zbatimin adekuat të dispozitave për paraburgimin me fokus në kushtet ligjore për aplikimin e tij dhe arsyetimin e vendimeve për caktimin e kësaj mase;
- unifikimin e praktikave me rastin e zbatimit të procedurës së konfirmimit të aktakuzës;
- ngritjen e kapaciteteve me rastin e aplikimit të drejtë të dispozitave për marrjen në pyetje dhe mbrojtjen e dëshmitarëve;
- ngritjen e shkathtësive praktike të hartimit të vendimeve dhe akteve tjera procedurale;
- zhvillimin e shkathtësive praktike për hetimin dhe konfiskimin e pasurisë së fituar me vepër penale;
- zbatimin e dispozitave ligjore dedikuar efikasitetit dhe shkurtimit të procedurës penale dhe
- ngritjes së shkathtësive të menaxhimit të rasteve.

- **Kodi i Drejtësisë për të Mitur**: Nga kuadër të trajnimeve lidhur me këtë kod janë realizuar temat si: masat dhe dënimet alternative ndaj të miturve – risitë e Kodit të Drejtësisë për të Mitur, procedura përgatitorë për të miturit, arrestimi, ndalimi dhe paraburgimi i të miturve si dhe ekzekutimi i masave dhe dënimeve ndaj të miturve.

Qëllimi i organizimit të këtyre aktiviteteve ishte: ngritja e nivelit të shqiptimit të masave dhe dënimeve alternative ndaj të miturve, shqyrtimi i risive të Kodit të Drejtësisë për të Mitur, identifikimi dhe aplikimi i standardeve ndërkombëtare në procedurat penale ndaj të miturve dhe unifikimi i praktikës me rastin e shqiptimit dhe ekzekutimit të masave dhe dënimeve ndaj të miturve.

Nga kjo lëmi janë realizuar edhe tryeza diskutimesh në pesë regjionet e Kosovës, me temë: "Funksionalizimi dhe Mbështetja e Grupeve Konsultative Joformale të Drejtësisë për të Mitur". Qëllimi i organizimit të këtyre tryezave ishte: diskutimi i sfidave dhe problemeve praktike me rastin e zbatimin e ligjshmërisë në fushën e drejtësisë për të mitur dhe theksimi i nevojës për koordinim më të mirë ndërinstitucional në zbatimin efikas të Kodit të Drejtësisë për të Mitur.

### 10.5.2. Trajnimet në Lëmin Civile, Administrative dhe të Punës

Në këtë kuadër, gjatë këtij viti janë realizuar 22 sesione trajnimi përmbajtja e të cilave kishte në fokus ngritjen e njohurive dhe shkathtësive të gjyqtarëve lidhur me aplikimin e instituteve juridike nga pjesa materiale dhe procedurale e të drejtës civile, përfshirë të drejtën e detyrimeve, atë komerciale, trashëgimore dhe familjare, por edhe nga lëmia administrative dhe e punës.



Foto 2. Trajnim në IGJK

Çështjet e trajtuara në trajnimet e pjesës civile (materiale e procedurale), familjare dhe trashëgimore ishin përfshirë në kuadër të temave si; procedura kontestimore (aspekte të ndryshme), pronësia dhe të drejtat tjera sendore, juridiksioni i gjykatave në kontestet pronësore, ligji kundër diskriminimit dhe çështjet pronësore, vendimet gjyqësore dhe veprimet kadastrale, shpronësimi, mbrojtja nga dhuna në familje përfshirë standardet ndërkombëtare kundër dhunës në familje, procedura e adoptimi të fëmijëve, trashëgimtarët e domosdoshëm, standardet ndërkombëtare të përmbarimit civil, ndërmjetësimi dhe ligji kundër diskriminimit.

Ndërsa temat si kontrata për ndërtimin, kontrata për licencën, lizingun, magazinimin dhe kontrollin e mallit, kontratat komerciale, kontrata për kredinë, arbitrazhi, kontratat për shitjen e mallrave sipas Konventës së OKB-së, ishin pjesë e diskutimit në trajnime të ndryshme nga fusha komerciale dhe e detyrimeve.

Risitë e ligjit për punën, kontestet e punës të shërbyesve civil, hartimi dhe arsyetimi i vendimeve gjyqësore janë trajtuar si pjesë të programit nga lëmia e të drejtës së punës dhe administrative.

Me rastin e trajtimit të këtyre çështjeve janë diskutuar aspekte përmbajtjesore të infrastrukturës ligjore vendore dhe instrumenteve ndërkombëtare.

### 10.5.3. Trajnimet nga Lëmia e Kundërvajtjeve

Nga lëmia e kundërvajtjeve janë realizuar 2 sesione trajnuese të veçanta për gjyqtarët për kundërvajtje. Temat të cilat u trajtuan në këto trajnime ishin:

- kundërvajtjet kundër rendit dhe qetësisë publike ku u diskutua lidhur me sjelljet arrogante, bezdisja publike dhe shkeljet që kanë të bëjnë me zhurmën, si dhe
- të miturit si kryes te veprave kundërvajtësve që për diskutim kishin masat dhe dënimet të cilat mund të ju shqiptohen të miturve në procedurën kundërvajtëse.

Me qëllim të mbështetjes së gjyqtarëve për kundërvajtje që të jenë pjesë e kapaciteteve për strukturën e re të sistemit gjyqësor e prokurorial, gjatë vitit 2011, përveç trajnimeve nga lëmia e kundërvajtjeve ata janë përfshirë edhe trajnimet e lëmive tjera.

### 10.5.4. Kodi i Etikës dhe Sjelljes Profesionale

Gjatë vitit 2011 janë realizuar 3 sesione trajnues të cilat kishin për objekt trajtimi Kodin e Etikës dhe Sjelljes Profesionale. Qëllimi i këtyre trajnimeve ishte që pjesëmarrësit të njoftohen me standardet e sjelljes profesionale në rast të aktiviteteve të gjyqtarit, prokurorit dhe avokatit, në mënyrë që ata të zhvillojnë aftësitë rreth sjelljeve të tyre në jetën personale dhe profesionale. Në kuadër të këtyre trajnimeve janë përfshirë temat si; parimet e përgjithshme të Kodit të Etikës dhe Sjelljeve Profesionale, procedura disiplinore pranë KGJK-së dhe sjelljet e pahijshme dhe rastet specifike nga praktika e zyrës së prokurorit disiplinor.

### 10.5.5. Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut

Pjesë e trajnimeve në PVAL ishte edhe diskutimi i disa aspekteve të rëndësishme nga Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNJ). Gjatë vitit 2011 janë realizuar 3 sesione trajnues të cilat përfshinin temat si; E drejta për liri dhe siguri (neni 5 i KEDNJ) me fokus në arsyet e privimit nga liria dhe kohëzgjatja e këtij privimi, E drejta për një proces të rregullt gjyqësor (neni 6 i KEDNJ) dhe E drejta për respektimin e jetës private dhe familjes (neni 8 KEDNJ). Qëllimi i trajtimit të këtyre temave ishte ngritja e shkathtësive praktike të gjyqtarëve dhe prokurorëve për zbatimin praktik të dispozitave të KEDNJ-së dhe mësimi nga rastet e trajtuara në Gjykatën e të Drejtave të Njeriut.

### 10.5.6. E Drejta e Bashkimit Evropian (*Acquis Communitaire)*



Foto 3. Prezantimi i ekspertëve ndërkombëtar për të Drejtën e BE-së

IGJK, në bashkëpunim me Programin e Binjakëzimit i cili mbështetë Reformimin e Sistemit të Arsimimit Ligjor në Kosovë i cili mbështetet nga fondet e BE-së kanë realizuar 6 sesione trajnuese lidhur, me të Drejtën e BE-së. E veçanta e këtyre sesioneve ishte kohëzgjatja katër dhe pesëditore si dhe realizimi nga trajnuesit ndërkombëtarë e vendorë. Gjatë realizimit të trajnimeve nga kjo lëmi, përqendrimi kryesor ishte në shtjellimin e temave nga e drejta civile dhe e drejta penale si: Lidhja në mes të Drejtës Evropiane dhe Konventës Evropiane mbi të drejtat e njeriut, kufizimi i principit të një gjykimi të drejtë, Konventa Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut, Burimet e së Drejtës Evropiane, Epërsia e së Drejtës Evropiane mbi të Drejtën Kombëtare, parësia në aplikimin e së Drejtës Evropiane, Liritë Fondamentale, trajtimi në të drejtën kombëtare, Rregulloret dhe Udhëzimet, efektet e tyre në të drejtën kombëtare; Gjykata e Bashkimit Evropian, përbërja e saj, detyrat dhe kompetencat, procedura para Gjykatës së Bashkimit Evropian, vendimi preliminar dhe funksionimi i tij, hyrje në mekanizmat e së Drejtës Evropiane në të drejtën penale, urdhër arresti Evropian, luftimi i krimit të organizuar, trafikimi me qenie njerëzore, armë, dhe substanca narkotike, krimet përtej kufitare dhe kooperimi policor.

## 10.6. Trajnime të specializuara në PVAL

### 10.6.1. Ndërtimi i shkathtësive të përfaqësimi gjatë gjykimit

Në mbështetje të Departamentit të Drejtësisë së SHBA-ve, Programit OPDAT, zyra në Prishtinë, gjatë vitit 2011, janë realizuar katër (4) sesione trajnimi tri ditore. Këto trajnime janë vazhdimësi e programit të njohur me emrin NITA realizohen nga ***trajnues vendor*** të çertifikuar nga Instituti Kombëtar i Avokimit gjatë Gjykimit (“NITA”), nga SHBA. Temat e trajtuara në kuadër të këtyre aktiviteteve janë: fjala hyrëse, marrja në pyetje e drejtpërdrejtë, marrja në pyetje e tërthortë, vënia në dyshim (impichment), rimarrja në pyetje dhe argumentimi përfundimtarë. Qëllimi i këtyre trajnimeve është fokusuar në ngritjen e shkathtësive praktike të përfaqësimit të rasteve në gjykim dhe ngritjes së efikasitetit të gjykimeve.

### 10.6.2. Ligji për mbrojtjen e ambientit

Në kuadër të trajnimeve të specializuara në këtë vit u realizua një trajnim Ligjin për Mbrojtjen e Mjedisit”. Gjatë këtij trajnimi u trajtuan në detale historiku, nocionet themelore dhe parimet udhëzuese të Konventës ndërkombëtare mjedisore, Legjislacioni i BE-së për mjedisin (obligimet nga Acquis communautaire për mbrojtjen e mjedisit) si dhe legjislacioni vendor për mbrojtjen e mjedisit.

### 10.6.3. Trajnimet nga të drejtat e njeriut dhe barazia gjinore

Me mbështetje nga UNWOMEN, zyra në Prishtinë, gjatë këtij viti janë mbajtur trajnime njëditore në pesë regjionet e Kosovës me tema: dhuna në familje, standardet ndërkombëtare dhe Ligji për Barazi Gjinore, të drejtat e fëmijëve dhe trafikimi me qenie njerëzore. Qëllimi i realizimit këtyre trajnimeve ishte ngritja e kapaciteteve të gjyqësorit të Kosovës dhe aktorëve tjerë të sistemit të drejtësisë nga lëmia e të drejtave të njeriut dhe barazia gjinore.

Gjithashtu IGJK në bashkëpunim me Qendrën Evropiane për Çështje të Minoriteteve (ECMI) dhe Qendrën për Ndihmë Juridike dhe Zhvillim Regjional (CLARD), organizoj një trajnim me temë ”Standardet ndërkombëtare kundër dhunës në familje, Ligji kundër Diskriminimit dhe Çështjet Pronësore”. Qëllimi i këtij trajnimi ishte zbatimi i standardeve ndërkombëtare në rastet e dhunës në familje, zgjerimi i njohurive lidhur me përmbajtjen e dispozitave kushtetuese dhe ligjore të cilat ndalojnë diskriminimin, përfshirë edhe në çështjet e pronësisë, në Republikën e Kosovës.

### 10.6.4. Organizimi i Gjykatave sipas Ligjit për Gjykata

Gjatë vitit 2011 është realizuar një sesion trajnues me qëllim që gjyqtarëve tu prezantohet struktura e Ligjit për Gjykata, si dhe të njoftohen në lidhje me aktivitetet përgatitore, hartimin akteve nënligjore dhe aktiviteteve planifikuese që janë ndërmarr për zbatimin e këtij ligji. Qëllimi kryesor i këtij trajnimi ishte ngritja e njohurive dhe zhvillimi i përgatitjeve gjithëpërfshirëse në zbatim të procesit të riorganizimit të gjykatave në Republikën e Kosovës.

### 10.6.5. Ligji për Prokurorin e Shtetit

Në kuadër të trajnimeve të veçanta për prokurorë, IGJK ka organizuar një sesionin trajnues me temë “Ligji për Prokurorin e Shtetit”. Çështjet e trajtuara në këtë trajnim si; identifikimi i kompetencave të Prokurorit të Shtetit, struktura organizative dhe juridiksioni i Prokurorit të Shtetit sipas përmbajtjes së Ligjit për Prokurorin e Shtetit kishin për qëllim ngritjen e njohurive rreth dispozitave të këtij ligji në frymën e përgatitjeve për zbatim sipas afateve të përcaktuara me ligj.

## 11. Programi Fillestar për Arsimim Ligjor (PFAL)

Ligji mbi Themelimin e Institutit Gjyqësor të Kosovës, përcakton se IGJK është institucioni kryesor përgjegjës për aftësimin bartësve potencial të funksionit në gjyqësi (kandidatëve për gjyqtarë dhe prokurorë), dhe obligon IGJK-në që të bëj vlerësimin dhe organizimin e provimit përgatitor për gjyqtarë dhe prokurorë. Bazuar në Ligjin e IGJK-së, Statutin, Kornizën e Aktiviteteve për Organizimin e Provimit Përgatitor/Hyrës dhe Programin Fillestar për Arsimim Ligjor si dhe praktikat e vendeve të rajonit, vendeve Evropiane dhe më gjerë, kandidatët për ushtrimin e funksionit të gjyqtarit apo prokurorit duhet që paraprakisht të kalojnë sistemin e trajnimeve fillestare të veçanta, të cilat organizohen në kuadër të Programit Fillestar për Arsimim Ligjor (PFAL).

PFAL është program trajnues i cili iu dedikohet kandidatëve për gjyqtarë dhe prokurorë të ardhshëm të cilët paraprakisht e kanë kaluar me sukses Provimin Përgatitor/Hyrës. Ky program trajnimi, sipas ligjit, organizohet dhe administrohet nga IGJK në bashkëpunim të ngushtë me KGJK dhe KPK. Qëllimi kryesorë i këtij programi është përgatitja profesionale e gjyqtarëve dhe prokurorëve të ardhshëm para emërimit të tyre në këto pozita. PFAL zhvillohet për një periudhë 15 mujore e ndarë në tri faza. PFAL ka filluar të zbatohet në shtator të vitit 2008. Gjenerata e parë dhe e dytë e kandidatëve të këtij programi tani më janë emëruar si gjyqtarë apo prokurorë në të gjitha nivelet e sistemit gjyqësor e prokurorial.

Gjatë vitit 2011 sistemi gjyqësor e prokurorial në Kosovë është shoqëruar me ndryshime e reforma të rëndësishme. Këto ndryshime janë reflektuar edhe në IGJK, përkatësisht në PFAL. Me qëllim të plotësimit të vendeve të lira për gjyqtarë dhe prokurorë të përcaktuara nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës, është bërë e domosdoshme që PFAL të organizohet për dy gjenerata të kandidatëve njëkohësisht dhe me një numër rekord të tyre. Kjo është mundësuar falë përkushtimit dhe angazhimit të madh të trajnuesve, stafit të IGJK-së të cilët kanë punuar intensivisht 6 ditë në javë, për disa muaj me radhë.

IGJK gjatë vitit 2011 ka arritur që me sukses të përfundojë trajnimet për gjeneratën e tretë të kandidatëve për gjyqtarë e prokurorë të ardhshëm të cilët kanë diplomuar në tetor 2011 dhe tani po kalojnë në fazën e vlerësimit për emërim. Aktualisht janë duke i ndjekur trajnimet kandidatët e gjeneratës së katërt (56) të cilët janë duke ndjekur trajnimet në fazën e dytë dhe të tretë njëkohësisht.

PFAL edhe pse funksionon vetëm që prej 4 vjetësh, tashmë ka krijuar përvojë solide në përgatitjen profesionale të kandidatëve të rinj të cilët aspirojnë të ushtrojnë funksionin e gjyqtarit apo prokurorit në Kosovë dhe standardet e organizimit të këtij programi janë të njohura nga i tërë komuniteti ligjor ndërkombëtarë dhe vendorë.

## 11.1. Trajnimet e PFAL (gjenerata e tretë)

Gjatë vitit 2011 kandidatët e gjeneratës së tretë të Programit Fillestar për Arsimim Ligjor kanë vazhduar trajnimet në fazën e parë dhe fazën e dytë të këtij programi.

### 11.1.1. Faza e parë

Faza e parë e trajnimeve zgjat 6 muaj. Në këtë fazë të gjithë kandidatët kanë ndjekur trajnimet sipas programit të njëjtë trajnues i ndarë në 12 module trajnuese. Kjo fazë për gjeneratën e tretë ka filluar në shtator 2010 dhe ka përfunduar në muajin shkurt 2011.

Secili modul trajnues është ndarë në 20 seksione ose prezantime, të cilat përfshijnë të gjithë materien e paraparë për atë modul. Trajnimet në këtë fazë realizohen në forma të ndryshme duke filluar nga prezantimet, diskutimet interaktive, ushtrimet praktike, studimi i rasteve nga praktika gjyqësore, punë në grupe, simulime gjykimi etj.



Foto 4. Kandidatët gjatë trajnimeve

Në këtë fazë kanë qenë të angazhuar 17 trajnues. Para se të filloi trajnimi në këtë fazë është organizuar një trajnim për trajnuesit të cilët janë angazhuar në këtë fazë. Qëllimi i këtij trajnimi ishte njoftimi i trajnuesve me objektivat e trajnimit në këtë fazë, zbatimin e programit trajnues, metodologjinë trajnuese si dhe është diskutuar për pritjet e trajnuesve dhe kandidatëve. Modulet trajnuese në të cilat kandidatët kanë ndjekur trajnimet në fazën e parë kanë qenë:




Grafikoni 7. Modulet trajnuese për fazën e parë të PFAL

Në fazën e parë, trajnimet i kanë ndjekur të gjithë kandidatët së bashku, pavarësisht profilit të tyre, gjyqtarë apo prokurorë.

Gjatë kësaj faze janë mbajtur 240 sesione trajnuese apo 60 ditë të plota trajnimi.




Grafikoni 8. Numri i kandidatëve sipas gjeneratave

### 11.1.2. Faza e dytë

Në këtë fazë bëhet profilizimi i kandidatëve (gjyqtarë dhe prokurorë) për vazhdim të mëtejmë të trajnimeve. Profilizimi bëhet sipas nevojave të sistemit gjyqësor e prokurorial të shprehura nga institucionet respektive. Në këtë fazë kandidatët për gjyqtarë kanë ndjekur trajnime në

module të ndryshme nga kandidatët për prokurorë, me përjashtim të 3 (tri) moduleve të cilat për shkak të përmbajtjes së tyre janë ndjekur nga të dy grupet njëkohësisht.

Faza e dytë e trajnimeve ka filluar në muajin mars dhe ka vazhduar deri në fund të qershorit 2011.



Foto 5. Kandidatët e PFAL III



Foto 6. Modulet trajnuese

Për realizimin e trajnimeve të fazës së dytë janë hartuar 23 module trajnuese. Secili grup i kandidatëve (gjyqtarë dhe prokurorë) ka ndjekur trajnime në 13 module trajnuese duke llogaritur edhe modulet e përbashkëta. Modulet trajnuese për kandidatët për gjyqtarë në fazën e dytë kanë qenë:




Grafikoni 9. Modulet trajnuese për fazën e dytë të PFAL – kandidatët për gjyqtarë

Ndërsa modulet trajnuese për kandidatët për prokurorë gjatë fazës së dytë janë si më poshtë:




Grafikoni 10. Modulet trajnuese për fazën e dytë të PFAL – kandidatët për prokurorë

Për realizimin e trajnimeve në këtë fazë për të dy grupet (kandidatët për gjyqtarë dhe prokurorë) janë angazhuar 26 trajnues. Gjatë kësaj faze janë mbajtur 144 sesione trajnuese ose 36 ditë trajnimi.

### 11.1.3. Organizimi, hartimi dhe zbatimi i provimeve në kuadër të PFAL

Sipas rregullave të programit, në fund të kësaj faze kandidatët iu nënshtrohen provimeve për secilin modul trajnues. Provimet organizohen me qëllim të vlerësimit të aftësive të fituara nga kandidatët që ndjekin trajnimet. IGJK ka organizuar provime në të gjitha modulet e të dy fazave për të gjithë kandidatët. Provimet hartohen dhe vlerësohen në mënyrë të pavarur nga trajnuesit e secilit modul përkatës, ndërsa administrohen nga IGJK, mbi bazën e rregullave të forta të konfidencialitetit dhe anonimitetit.



Foto 7. Kandidatët e PFAL gjatë provimit në kuadër të PFAL

Rregullat për organizimin dhe administrimin e këtij provimi kanë qenë të njëjta me rregullat e zbatuara në Provimin Përgatitor/Hyrës[2]. Gjatë hartimit, organizimit, administrimit dhe

[2] Shih Raportin për Hartimin dhe Vlerësimin e Provimit Përgatitor www.kjijudicial.org

vlerësimit të këtij provimi janë aplikuar standardet më të larta që aplikojnë institucionet ndërkombëtare të trajnimit në Evropë dhe më gjerë dhe të njëjtat janë organizuar nën monitorimin ndërkombëtarë të vëzhguesve të OSBE-së.

### 11.1.4. Faza e tretë

Trajnimet në fazën e tretë të PFAL kanë filluar krahas me trajnimet në fazën e dytë. Kjo ka ndodhur për faktin se nevojat për plotësimin e vendeve të lira në sistemin gjyqësor kanë qenë të ngutshme, prandaj me qëllim që të fitohet në kohë kandidatët kanë ndjekur trajnimet e fazës së tretë krahas fazës së dytë.

Trajnimet e fazës së tretë janë zhvilluar në gjykata dhe prokurori nën mbikëqyrjen e mentorit gjyqtarë apo prokurorë. Programi trajnues për këtë fazë ka qenë ekskluzivisht praktik dhe ka qenë i lidhur me punën e gjyqtarit apo prokurorit mentor. Kandidatët kanë marrë detyra të caktuara me program dhe i kanë realizuar ato nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejt të mentorit. Kjo punë praktike e kandidatëve është cilësuar edhe si mbështetje e gjyqtarit apo prokurorit pasi që kandidatët kanë qenë të angazhuar në punimin e rasteve reale në gjykatë, përkatësisht prokurori.

Gjatë fazës së tretë kandidatët kanë qenë të shpërndarë në 8 gjykata dhe 6 prokurori të nivelit komunal, në pothuajse të gjitha regjionet e Kosovës.

Në gjeneratën e tretë kanë ndjekur trajnimet 32 kandidatë, prej tyre 22 janë meshkuj, 10 femra, 31 shqiptar ndërsa 1 nga komuniteti boshnjak. Trajnimet janë ndjekur nga 21 kandidatë për gjyqtarë dhe 11 kandidatë për prokurorë.




Grafikoni 11. Numri i ditëve të trajnimit në PFAL III

## 11.2. Vizita e kandidatëve në Akademinë Gjyqësore të Turqisë

Në kuadër të bashkëpunimit të ngushtë të IGJK-së dhe Akademisë Gjyqësore të Turqisë, është realizuar një program trajnimi për kandidatët e gjeneratës së tretë të PFAL në Akademinë Gjyqësore dhe institucionet tjera të sistemit të drejtësisë në Republikën e Turqisë.

Në kuadër të këtij programi, kandidatët kanë pasur mundësin të ndjekin trajnime në tema si: Etika profesionale gjyqësore, menaxhimi i stresit, e drejta për një gjykim të drejtë, reflektimi i vendimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejta të Njeriut në të drejtën vendore, ekzekutimi i sanksioneve penale dhe teknikat e marrjes në pyetje.

Gjatë këtij trajnimi kandidatët u informuan edhe për sistemin gjyqësor të Turqisë, sistemi elektronik i menaxhimit të drejtësisë, vizituan Departamentin Penal të Gjendarmerisë dhe Institutin e Mjekësisë Ligjore.

## 11.3. Ceremonia e diplomimit

Pas përfundimit të trajnimit është organizuar një ceremoni solemne me rastin e diplomimit të gjeneratë së tretë të kandidatëve për gjyqtarë dhe prokurorë e cila shënoj përfundimin e trajnimeve dhe kualifikimin profesional të kandidatëve.

Në këtë ceremoni morën pjesë; Presidentja e Republikës së Kosovës, Kryetari i Gjykatës Supreme të Kosovës, Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Kryeprokurori i Shtetit Ambasadori i SHBA-ve në Kosovë, Udhëheqësi i Operacioneve në Zyrën ndërlidhëse të Komisionit Evropian në Kosovë, Ambasadori i Holandës në Kosovë,  të cilët mbajtën fjalë rasti dhe vlerësuan lartë punën e IGJK-së.

Me përfundimin e kësaj ceremonie kandidatët i plotësojnë të gjitha kriteret formale ligjore dhe janë të gatshëm për emërim.



Foto 8. Kandidatët e PFAL III në ceremoninë e diplomimit

***Tre (3) nga 32 kandidatët e kësaj gjenerate janë emëruar në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, ndërsa të tjerët janë në procesin e vlerësimit nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës.***

## 11.4. Trajnimet e PFAL (gjenerata e katërt)

Duke iu përgjigjur nevojave të sistemit gjyqësor dhe prokurorial në Kosovë për plotësimin e vendeve të lira, gjatë vitit 2011 IGJK është përballur me sfidën e organizmit të trajnimeve edhe për gjeneratën e katërt të kandidatëve për gjyqtarë dhe prokurorë në PFAL, njëkohësisht derisa po zhvillohej trajnimi për gjeneratën e tretë të këtij programi. Ky angazhim njëkohësisht ka qenë sfidë edhe për faktin se IGJK-së i është dashur të organizoj trajnime për

një numër shumë më të madh të kandidatëve krahasuar me gjeneratat tjera, gjë e cila ka pasur efekt direkt në planin e punës dhe buxhetin e IGJK-së për vitin 2011.

## 11.5. Provimi Përgatitor/Hyrës[3] për gjeneratën e katërt të PFAL

IGJK si institucion kryesor përgjegjës për aftësimin bartësve potencial të funksionit në gjyqësi (kandidatëve për gjyqtarë dhe prokurorë) sipas ligjit, ka mandat që të organizoj Provimin Përgatitor/Hyrës për kandidatët për gjyqtarë dhe prokurorë. Përgatitjet për organizimin e provimit për gjeneratën e katërt kanë filluar në muajin mars 2011, kur edhe janë përcaktuar detajet e provimit si dhe është bërë shpallja publike me të cilën janë ftuar kandidatët e interesuar për aplikim**.**

Me qëllim të hartimit, organizimit, administrimit dhe vlerësimit të Provimit Përgatitor/Hyrës, Këshilli Programor i IGJK-së ka miratuar Rregullat dhe Strukturën e Provimit Përgatitor/Hyrës. Sipas strukturës së miratuar nga Këshilli Programor, provimi ka pasur 6 pjesë:

- Testi i aftësive analitike dhe analizë e tekstit;
- Etikë gjyqësore;
- Zgjidhje e shumëfishtë ligjore;
- Ese me shkrim;
- Rast praktik (civile me shkrim);
- Rast praktik (penale me gojë);

Lidhur me procedurat e hartimit, administrimit dhe vlerësimit të provimit IGJK ka krijuar rregullat të cilat e ruajnë konfidencialitetin e provimit. Pjesë e këtyre rregullave është edhe hartimi i provimit jashtë vendit. Provimi për gjeneratën e katërt është hartuar në Shqipëri në mbështetje të UNDP-së, nga data 07-12 mars 2011 nga Komisioni për Hartimin dhe Vlerësimin e Provimit Përgatitor/Hyrës. Përbërja e komisionit u miratua nga Këshilli Drejtues i IGJK-së, anëtarë të të cilit kanë qenë përfaqësuesit më të lartë të sistemit gjyqësor e prokurorial në Kosovë, gjyqtarë, prokurorë, profesorë dhe avokat.



Foto 9. Grupi punues për Hartimin e Provimit Përgatitor/Hyrës

Provimi me shkrim u administrua më 02 prill 2011, në Qendrën e Kosovës për Siguri Publike Edukim dhe Zhvillim, ndërsa më 16 prill 2011 është mbajtur provimi me gojë në IGJK.

[3] Lidhur me hartimin, mbajtjen dhe vlerësimin e Provimit Përgatitor/Hyrës është përgatitur dhe publikuar raport i veçantë, www.kjijudicial.org

Provimin Përgatitor me sukses e kaluan 42 kandidatë të cilët fituan të drejtën për të ndjekur trajnimet në Programin Fillestar për Arsimim Ligjor (gjenerata e IV).



Foto 10. Grupi punues për Hartimin e Provimit Përgatitor/Hyrës

Përveç këtyre kandidatëve, Këshilli Gjyqësor i Kosovës kishte pranuar edhe rezultatet e Provimit Përgatitor të vitit 2009 i cili ishte organizuar në bashkëpunim të KPGJP-së dhe IGJK-së. Sipas këtij vendimi të drejtën për të ndjekur trajnimet në këtë program në gjeneratën e katërt e fituan të gjithë ata kandidatë që kishin kaluar me sukses këtë provim, por për të ndjekur trajnimet në PFAL në gjeneratën e katërt e shfrytëzuan vetëm 14 kandidatë të cilët ju bashkëngjiten 42 kandidatëve që kishin përfunduar me sukses këtë provim gjatë vitit 2011. Si rezultat i këtyre zhvillimeve gjenerata e katërt e PFAL përfshinë 56 kandidatë të cilët kanë ndjekur trajnimet në këtë program.

Lidhur me hartimin, administrimin dhe vlerësimin e provimit IGJK ka hartuar një raport detal i cili është publikuar në kohën e publikimit të rezultateve dhe gjendet në web faqen e IGJK-së.



Foto 11. Provimi Përgatitor me shkrim



Foto 12. Provimi Përgatitor me gojë

## 11.6. Ceremonia e fillimit të PFAL IV

Sipas traditës së IGJK-së, PFAL fillon me organizmin e një ceremonie solemne në të cilën marrin pjesë përfaqësues të lartë shtetëror dhe ndërkombëtarë. Në këtë drejtim më 11 maj 2011, u organizua ceremonia e fillimit të PFAL për gjeneratën katërt të kandidatëve për gjyqtarë dhe prokurorë. Në këtë ceremoni morën pjesë; Presidentja e Republikës së Kosovës, zv. Kryeministri dhe Ministri i Drejtësisë, kryetari i Gjykatës Supreme të Kosovës, kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Kryeprokurori i Shtetit. Në fjalimet e tyre ata përgëzuan IGJK-në për mbështetjen e dhënë sistemit gjyqësor e prokurorial me kuadro të reja si dhe premtuan mbështetje me qëllim të avancimit të punës dhe rezultateve të IGJK-së. Në këtë

ceremoni morën pjesë edhe përfaqësues të lartë të institucioneve ndërkombëtare dhe vendore të cilat ndihmojnë apo janë pjesë e sistemit gjyqësor e prokurorial në Kosovë.

## 11.7. Trajnimet në PFAL IV

### 11.7.1. Faza e parë

Trajnimet për gjeneratën e katërt të kandidatëve për gjyqtarë dhe prokurorë kanë filluar me 12 maj 2011, dhe janë organizuar në mënyrë intensive 6 (gjashtë) ditë në javë për gjashtë muaj rresht deri në përfundimin e fazës parë. Gjatë kësaj periudhe kandidatët kanë ndjekur trajnimet në IGJK tri (3) ditë, ndërsa tri ditë tjera kanë ndjekur trajnimet praktike në fazën e tretë (fazën e mentorimit). Edhe kjo gjeneratë e kandidatëve ka ndjekur trajnimet në modulet e njëjta trajnuese sikurse gjeneratat e mëparshme.



Foto 13. Kandidatët gjatë trajnimeve

### 11.7.2. Faza e dytë

Edhe trajnimet në fazën e dytë, të gjeneratës së katërt të PFAL janë organizuar me intensitet të lartë por vetëm 5 ditë në javë. Numri i moduleve, trajnuesve dhe struktura e agjendës në këtë fazë kanë qenë të njëjta me atë të gjeneratës së tretë.

### 11.7.3. Faza e tretë

Trajnimet në fazën e tretë të PFAL kanë filluar krahas me trajnimet në fazën e parë. Kjo agjendë ishte dizajnuar e tillë për arsye të nevojës urgjente për plotësimin e vendeve të lira në sistemin gjyqësor e prokurorial.

Edhe për gjeneratën e katërt të kandidatëve, trajnimet e fazës së tretë janë zhvilluar në gjykata dhe prokurori nën mbikëqyrjen e mentorit (gjyqtarë apo prokurorë). Programi trajnues për këtë fazë ka qenë i njëjtë dhe është realizuar sipas të njëjtës metodologji sikur edhe për gjeneratat e mëparshme (shih më lartë tek gjenerata e tretë). Kandidatët kanë qenë të shpërndarë në 15 gjykata dhe 6 prokurori të nivelit komunal, në pothuajse të gjitha regjionet e Kosovës.




Grafikoni 12. Numri i kandidatëve të trajnuar në PFAL IV

Nevoja urgjente për plotësimin e vendeve të lira për gjyqtarë dhe prokurorë ka diktuar hartimin e një agjende me trajnime intensive (6 ditë në javë). Kjo agjendë ka bërë të mundur që programi trajnues për gjeneratën e katërt të përfundoj në një periudhë më të shkurtër kohore, përkundër faktit që numri i orëve dhe moduleve trajnuese ka mbetur i njëjtë me atë të gjeneratave tjera të PFAL.

Në gjeneratën e katërt janë duke i ndjekur trajnimet 56 kandidatë, prej tyre 40 meshkuj dhe 16 femra. Me diplomimin e këtyre kandidatëve dhe atyre të gjeneratës së tretë të cilët tashmë kanë filluar të emërohen, IGJK ka dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm në plotësimin e vendeve të lira të gjyqtarëve dhe prokurorëve, duke ofruar kandidatë me përgatitje të lartë profesionale për këto pozita, përkundër sfidave të mëdha me të cilat është ballafaquar gjatë vitit 2011. Kjo është arritur edhe duke falënderuar mbështetjes së institucioneve vendore partnere në këtë proces dhe partnerëve ndërkombëtarë të IGJK-së.




Grafikoni 13. Numri i kandidatëve të trajnuar sipas gjeneratave

### 11.8. Aktivitetet shtesë të kandidatëve të PFAL

Përveç trajnimeve në modulet e lartshënuara kandidatët për gjyqtarë dhe prokurorët të gjeneratës së tretë dhe të katërt kanë ndjekur edhe disa trajnime speciale dhe aktivitete tjera profesionale nga fusha të ndryshme të drejtësisë me të cilat është synuar që të plotësohen shkathtësitë e tyre. Këto aktivitete kanë qenë:

- Trajnimi lidhur me dhunën në familje;
- E Drejta Evropiane në praktikë - hyrje dhe përqendrim në të drejtën penale;
- E Drejta Evropiane në praktike - hyrje dhe përqendrim në të drejtën civile;
- Simulime gjykimi; dhe
- Mbrojtja e viktimave të trafikimit;

Këto aktivitete kanë ndihmuar kandidatët në marrjen e informacioneve të detajuara lidhur me zbatimin praktik të ligjeve të ndryshme.

## 12. Programi i trajnimit për avancim (PTA)

Programi i Trajnimit për Avancim të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve (PTA) përfshinë organizimin e kurseve të posaçme aftësimi për gjyqtarë dhe prokurorë që janë apo do të avancohen brenda sistemit gjyqësor dhe prokurorial të Kosovës. PTA, bazën ligjore e ka në Ligjin mbi Themelimin e IGJK-së. Sipas këtij ligji, gjyqtarët dhe prokurorët e posa emëruar kanë të drejtë dhe janë të obliguar të marrin pjesë në kurset e veçanta për aftësim dhe avancim, pa shkëputje nga marrëdhënie e punës.

Në kuadër të PTA gjatë vitit 2011 janë zhvilluar trajnime në kuadër të 13 moduleve trajnuese. Këto trajnime u ishin dedikuar gjyqtarëve dhe prokurorëve të posa emëruar, atyre që kanë ndërruar profilet si dhe atyre që kanë kaluar nga një nivel në tjetër në kuadër të gjykatave apo prokurorive.

Në kuadër të 13 moduleve janë realizuar 19 (nëntëmbëdhjetë) aktivitete trajnuese. 2 (dy) prej këtyre aktiviteteve kanë pasur për objekt trajtimi menaxhimin e lëndëve dhe janë mbështetur nga USAID (NCSC), Projekti për Mbështetje të Drejtësisë në Kosovë, ndërsa 2 (dy) aktivitete të tjera ku janë trajtuar teknikat e avancuara të përfaqësimit gjatë gjykimit, janë mbështetur nga Departamenti i Drejtësisë së SHBA-ve (OPDAT) dhe Instituti Kombëtar i Avokimit gjatë Gjykimit (NITA). 15 aktivitete të tjera janë organizuar nga vet IGJK. Lista me të dhënat e moduleve trajnuese është dhënë si më poshtë:

| Modulet trajnuese | Kohëzgjatja | Numri i sesioneve të mbajtura | Përfitues: gjyqtarët dhe prokurorët e sapoemëruar |
|---|---|---|---|
| Konventa Evropiane për Liritë dhe të Drejtat Themelore të Njeriut | 1 ditore | 2 sesione | Regjionale |
| Menaxhimi i rasteve | 1 ditore | 2 sesione | Regjionale |
| Krimi i Organizuar | 2 ditore | 1 sesion | Të nivelit të qarkut |
| E drejta e Be-së | 2 ditore | 1 sesion | Të gjitha niveleve |
| Kodi i Drejtësisë për të Mitur | 1 ditore | 1 sesion | Gjyqtarët dhe prokurorët për të mitur |
| Kodi Penal dhe Kodi i Procedurës Penale | 2 ditore | 1 sesion | Të gjitha niveleve |
| Ndërtimi i Shkathtësive të Përfaqësimit gjatë Gjykimit | 3 ditore | 2 sesione | Të gjitha niveleve |
| Marrëveshja për pranimin e fajësisë | 2 ditore | 3 sesione | Të gjitha niveleve |
| E Drejta Kushtetuese | 1 ditore | 1 sesion | Të gjitha niveleve |
| E Drejta Civile Materiale dhe Procedurale | 1 ditore | 2 sesione | Gjyqtarët e lëmisë civile nga gjitha nivelet |
| Etika Gjyqësore dhe Prokuroriale | 1 ditore | 1 sesion | Të gjitha nivelet |
| Akti Administrativ dhe Konflikti Administrativ | 1 ditore | 1 sesion | Të nivelit komunal dhe për kundërvajtje |
| Shkrimi dhe Arsyetimi ligjor | 1 | 1 sesion | Gjyqtarët dhe prokurorët nga gjitha nivelet |

Tabela 1. Modulet trajnues në PTA

Nga kjo tabelë shihet se gjatë vitit 2011 në kuadër të PTA-së janë realizuar; 6 sesione trajnuese në lëmine penale, 4 në lëmine civile administrative dhe kushtetuese, 2 nga Konventa Evropiane për Liritë dhe të Drejtat Themelore të Njeriut, 1 për të drejtën e BE-së, 1 sesion trajnues për Etikë, 2 sesione për menaxhim të rasteve, 2 për zhvillim të teknikave të përfaqësimit gjatë gjykimit dhe 1 sesion trajnues për shkrimin dhe arsyetimin ligjor.




Grafikoni 14. Trajnimet në bazë të kohëzgjatjes

## 12.1. Pjesëmarrja në trajnime në Programin e Trajnimeve për Avancim



Gjatë vitit 2011 interesimi dhe vijueshmëria në trajnime në kuadër të PTA ishte i një niveli të lartë. Kjo dëshmohet me faktin se numri i përgjithshëm i vijuesve të PTA-së gjatë këtij periudhe ishte 330 gjyqtarë dhe prokurorë. Në kuadër të PTA-së gjatë vitit 2011 nga numri i përgjithshëm 77 pjesëmarrës ishin të gjinisë femërore ndërsa numri prej 253 pjesëmarrësish i takon gjinisë mashkullore.

Foto 14. Trajnim në PTA

Në vijim grafikoni nr. 14 pasqyron në mënyrë të detajuar pjesëmarrjen në trajnimet e realizuara në PTA për vitin 2011.




Grafikoni 15. Pjesëmarrja në trajnime në PTA

## 12.2. Pjesëmarrja dhe numri i trajnimeve në baza mujore në kuadër të PTA

Në vijim në mënyrë të detajuar pasqyrojmë numrin e trajnimeve të realizuara brenda periudhave mujore dhe numrin e pjesëmarrësve gjatë secilit muaj.




Grafikoni 16. Numri i pjesëmarrësve në baza mujore

## 12.3. Trajnimi i gjyqtarëve porotë

Në kuadër të mandatit të tij IGJK ka përgjegjësi organizimin e trajnimeve edhe për gjyqtarë porotë. Në kuadër të këtij programi gjatë vitit 2011 janë organizuar dy sesione trajnuese të karakterit regjional. Në këto sesione trajnuese janë trajtuar çështje të ndryshme që kanë të bëjnë me rolin e gjyqtarëve porotë në marrjen e vendimeve në procedurat për të rritur dhe për të mitur, zbatimin e Ligjit mbi Familjen si dhe janë trajtuar çështjet e sjelljes etike dhe profesionale të gjyqtarëve porotë.




Foto 15. Trajnimi për gjyqtarë porotë

Këto sesione trajnuese i kanë vijuar 30 gjyqtarë porotë nga gjykatat regjionale të Prishtinës, Gjilanit, Mitrovicës, Pejës dhe Prizrenit. Qëllimi i këtyre trajnimeve ishte ngritja e kapaciteteve të gjyqtarëve porotë me rastin e vendosjes së rasteve praktike në gjykatë dhe ngritja e reputacionit dhe pozitës së tyre.

## 12.4. Trajnimi i profesionistëve tjerë nga lëmi i gjyqësisë

IGJK ka përgjegjësi ligjore që të identifikojë profesionistët në lëmin e gjyqësisë dhe të organizojë për ta kurse të veçanta trajnimi. Në këtë drejtim gjatë vitit 2011, IGJK ka realizuar 12 aktivitete trajnuese ku përfitues kanë qenë bashkëpunëtorët profesional dhe zyrtarët përmbarues të gjykatave dhe prokurorive të Kosovë.



Fig. 16. Foto nga trajnimet për bashkëpunëtorët profesional

Për bashkëpunëtorët profesional janë realizuar 5 sesione trajnuese, 4 prej të cilave janë mbështetur nga OSBE/ODIHR. Qëllimi i këtyre aktiviteteve ishte hulumtimi dhe qasja në bazën e të dhënave për krime të luftës në Tribunalin Ndërkombëtar të Hagës dhe mundësia e përdorimit të materialeve përkatëse dhe ekspertizës së ICTY-së.

Ndërsa në një sesion të organizuar nga IGJK u trajtua roli i bashkëpunëtorëve profesional në sistemin e drejtësisë, etika, legjislacioni i Kosovës për të drejta të njeriut në raport me legjislacionin ndërkombëtar, shkrimi i urdhëresave, aktvendimeve dhe aktgjykimeve.

Për zyrtarët përmbarimor, gjatë vitit 2011 janë realizuar 7 sesione trajnuese, 6 prej të cilave për 30 zyrtarë të rinj përmbarimor dhe 1 sesion trajnues për zyrtarët përmbarues në detyrë. Programi për zyrtarët e rinj përmbarimor ishte dizajnuar në atë formë që për 2 (dy) javë ata kanë vijuar trajnimet në 6 (gjashtë) module trajnuese në të cilat janë përfshirë aspekte të ndryshme të procedurës përmbarimore, ndërsa 2 (dy) javë të tjera i janë nënshtruar punës praktike nëpër gjykata me ç'rast janë monitoruar nga mentorët e tyre të caktuar nga kryetarët e gjykatave. Qëllimi i këtij programi ka qenë përgatitja dhe aftësimi i kuadrove të reja për të zbatuar detyrimet ligjore dhe procedurale në zbatimin efektiv të procedurave përmbarimore në praktikë.

Modulet trajnuese të cilat janë përfshirë në kuadër të këtij programi janë:

| Modulet trajnuese | Kohëzgjatja | Numri i sesioneve të mbajtura | |
|---|---|---|---|
| Hyrje në përmbarim | 1 ditore | 1 sesion | Përfitues 30 zyrtarë të rinj përmbarimor |
| Komunikimi me shkrim | 1 ditore | 1 sesion | |
| Masat përmbarimore pjesa 1 | 1 ditore | 1 sesion | |
| Masat përmbarimore pjesa 2 | 1 ditore | 1 sesion | |
| Etika | 1 ditore | 1 sesion | |
| Iniciativa për zvogëlimin e lëndëve të grmbulluara | 1 ditore | 1 sesion | |

Tabela 2. Modulet trajnuese për zyrtarët e përmbarimit

Ky program ju ka ofruar zyrtarëve përmbarues një përmbledhje të procedurave për përmbarimin nga fillimi deri në fund me çka ju ka ndihmuar atyre në zbatimin e kornizës ligjore dhe procedurale përmbarimore ndaj situatave faktike.





Foto 17. Trajnimet për zyrtarë të rinj përmbarimor

Ndërsa për zyrtarët përmbarimor në detyrë është realizuar një sesion trajnues me ç'rast janë trajtuar çështjet specifike që kanë të bëjnë me procedurën përmbarimore me theks të veçantë lidhur me propozimin përmbarimor dhe rastet e përmbarimit civil në sendet e luajtshme dhe nga xhirollogaritë bankare dhe njëkohësisht është trajtuar edhe udhëzimi i nxjerrë nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës i cili referonte zbatimin e aktvendimeve për përmbarimin duke debituar llogaritë bankare të klientëve.

Në vijim po pasqyrojmë në mënyrë të detajuar numrin e trajnimeve të realizuara në të gjitha programet e lartpërmendura.




Grafikoni 17. Aktivitetet e realizuara në PTA dhe për profesionistë tjerë të sistemit gjyqësore prokurorial

# 13. Konferencat

## 13.1. Konferenca Vjetore për Gjyqësorin e Kosovës

Nën organizimin e përbashkët në mes të Gjykatës Supreme, Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Institutit Gjyqësor të Kosovës, dhe OSBE-së Misioni në Kosovë, më 3 dhjetor 2011 u organizua Konferenca Vjetore për Gjyqësorin e cila është konferenca parë e këtij lloji në Kosovë.

Qëllimi i kësaj konference ishte diskutimi lidhur me pavarësinë e gjyqësorit dhe risitë lidhur me zbatimin e Ligjit për Gjykatat, adresimin e çështjeve që ndërlidhen me Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Gjykatën Supreme dhe me administrimin e drejtësisë si dhe raportimet nga të gjitha pesë gjykatat e qarkut lidhur me sfidat e identifikuara në procesin e zbatimit të Ligjit për Gjykatat dhe administrimin e drejtësisë.

Në këtë konferencë morën pjesë të gjithë gjyqtarët e Kosovës të cilët patën rastin të shprehin shqetësimet e tyre për sfidat aktuale dhe ato që do të dalin si pasojë e zbatimit të Ligjit për Gjykatat, si dhe të japin alternativat për tejkalimin e këtyre sfidave. Përveç tërë gjyqësorit në Kosovë, në këtë konferencë morën pjesë dhe të ftuar nga vendet e rajonit, përfaqësues të këshillave gjyqësore nga Turqia (përfshirë përfaqësuesit e Akademisë së Drejtësisë), Maqedonia, Mali i Zi si dhe nga Shqipëria. Morën pjesë edhe të ftuar nga institucionet ndërkombëtare që mbështesin gjyqësorin e Kosovës.

Përfundimet dhe rekomandimet e kësaj konference do t'i shërbejnë sistemit gjyqësor të Kosovës në ngritjen e efikasitetit në zbatimin e reformave të parapara me Ligjin për Gjykata.

## 13.2. Konferenca vjetore e "Drejtësisë për të Mitur"

Në mbështetje të UNICEF, IGJK ka realizuar një konferenca vjetore nga lëmi i drejtësisë për të mitur. Diskutimet kryesore në këtë konferencë janë përqendruar në sfidat dhe problemet kryesore të shfaqura gjatë zbatimit të ligjshmërisë në fushën e drejtësisë për të mitur në Kosovë si dhe janë nxjerr rekomandime konkrete për përmirësimin e gjendjes në këtë fushë.

Qëllimi i konferencës ishte diskutimi i sfidave kyçe me të cilat po ballafaqohet sistemi i drejtësisë për të mitur në Kosovë, analizimi i rekomandimeve të dala nga trajnimet regjionale në fushën e drejtësisë për të mitur, propozimi i zgjidhjeve konkrete për problemet e identifikuara si dhe përcaktimi i hapat për të ardhshëm. Pjesëmarrësit në konferencë ishin të gjithë aktorët e përfshirë në lëmin e drejtësisë për të mitur në Kosovë.

## 13.3. Konferenca e parë vjetore e të diplomuarve në IGJK

Në vitin 2011 IGJK, për herë të parë organizoi një konferencë vjetore për ish kandidatët e diplomuar të gjeneratës parë dhe të dytë të PFAL, të cilët tashmë janë të emëruar si gjyqtarë apo prokurorë. Gjatë kësaj konference janë diskutuar çështje shumë të rëndësishme të tilla si; lidershipi, hartimi dhe arsyetimi i mirë i opinioneve ligjore, etika, përvojat gjatë ushtrimit të funksionit të gjyqtarit dhe prokurorit, sfidat dhe zgjidhjet adekuate. Gjyqtarët dhe prokurorët e rinj të sapoemëruar adresuan shumë çështje që kanë të bëjnë me punën e tyre të përditshme në

gjykata dhe prokurori. Një panel i prokurorëve dhe gjyqtarëve ishte pjesë e konferencës për t'iu përgjigjur pyetjeve të ndryshme të pjesëmarrësve.

Këtë lloj të konferencës IGJK synon ta bëj tradicionale, me qëllim që të vazhdoj mbështetja për gjyqtarë dhe prokurorë e rinj të cilët kalojnë nëpër programet e IGJK-së. Kjo formë e mbështetjes do të krijojë mundësinë që ata të shprehen për sfidat, problemet dhe çështjet tjera të karakterit profesional dhe në të njëjtën kohë t'iu ofrohen alternativa për zgjidhjen e situatave të shumta me të cilat mund të ballafaqohen gjatë punës së tyre si gjyqtarë apo prokurorë fillestar. Kjo konferencë do të shërbej edhe në modifikimin dhe ngritjen e cilësisë së trajnimeve në PFAL nëpërmjet ideve të cilat do t'i japin gjyqtarët dhe prokurorët që dikur ishin kandidatë të këtij programi.

## 13.4. Trajnimi i Trajnuesve

IGJK, në vazhdimësi i kushton kujdes aplikimit të metodave të avancuara të prezantimit gjatë trajnimit. Në këtë drejtim edhe gjatë vitit 2011 janë organizuar trajnime për trajnuesit të cilët marrin pjesë në hartimin dhe realizimin e programeve trajnuese të IGJK-së. Këto trajnime kryesisht janë organizuar në mbështetje nga partnerë të IGJK.

Në mbështetje të UNWOMEN është mbajtur trajnim i specializuar dy ditor në fushën e Barazisë Gjinore. Qëllimi i këtij trajnimi ishte ngritja e kapaciteteve trajnuese të IGJK-së nga fusha e të drejtave të njeriut, me theks të veçantë të drejtave të grave. Në përfundim të këtij trajnimi janë çertifikuar 19 trajnues. Ndërkaq, në mbështetje profesionale dhe financiare të UNDP dhe OSBE është realizuar një trajnim dy ditorë i nivelit bazik dhe një trajnim dy ditorë i nivelit të avancuar. Në këto dy trajnime kanë marrë pjesë 44 trajnues.

Ngritja e kapaciteteve për trajnuesit e IGJK-së nga lëmi i të Drejtës së BE-së ka vazhduar edhe gjatë vitit 2011. Ky program është realizuar në bashkëpunim me Programin e Binjakëzimit, i cili me fonde të BE-së mbështet Reformimin e Sistemit për Arsimim Ligjor në Kosovë. Me këtë rast gjatë vitit 2011 janë realizuar 6 sesione tre ditore trajnimi për trajnues nga E Drejta e BE-së. Pas përfundimit të këtyre trajnimeve grupi i trajnuesve ka filluar mbajtjen e trajnimeve nga kjo lëmi. Në përfundim të këtij trajnimi janë çertifikuar 17 trajnues.

Gjithashtu në bashkëpunim me UNICEF është realizuar edhe një trajnim tre ditorë në kuadër të Programit të Trajnimit për Trajner në fushën e Drejtësisë për të Mitur në Kosovë. Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarë dhe prokurorë të cilët punojnë me rastet e të miturve, nga gjykatat dhe prokuroritë e të gjitha niveleve dhe regjioneve të Kosovës. Gjatë këtij trajnimi janë identifikuar 7 kandidatë për të vazhduar procesin e certifikimit të tyre në këtë fushë.

Përfitues të trajnimeve për trajnues janë, gjyqtarët, prokurorët, avokatët, profesorët dhe profesionistët tjerë të cilët zbatojnë programet për arsimim ligjor të IGJK-së.



Foto 19. Trajnim i Trajnuesve

# 14. Administrata dhe Financat

## 14.1. Administrata

Në strukturën organizative të IGJK-së në vitin 2011 ishin përfshirë 22 nëpunës të karrierës dhe një nëpunës jo i karrierës, i rekrutuar për projekt të veçantë të IGJK-së. Në kuadër të strukturës organizative, e rregulluar me akte të brendshme, vepron: Drejtoria e IGJK-së, Departamenti i Programit i udhëhequr nga Koordinatori i Programit dhe Departamenti për Administratë dhe Financa i udhëhequr nga Drejtori për Administratë dhe Financa. Pavarësisht kërkesës së vazhdueshme të IGJK-së për rritje të stafit me pozita të nevojshme, në vitin 2011 numri i stafit u rrit vetëm për një pozitë (teknologji informative).

Shërbimet administrative kanë për objektiv sigurimin e mbështetjes administrative për realizimin e aktiviteteve të trajnimit dhe zbatimin e politikave zhvillimore në fushën e administratës.

Në kuadër të detyrave dhe përgjegjësive, aktivitetet që përfshihen në vitin 2011 kryesisht kishin të bëjnë me punët administrative në tërësi, personelin, teknologjinë informative dhe shërbimet e logjistikës.

Aktivitetet përmbledhëse që mund të veçohen në kuadër të administratës janë:

- **Zbatimi i Ligjit për Shërbyesit Civil**: përveç tjerash sipas Ligjit për Shërbyes Civil, IGJK shndërron të gjitha kontratat e stafit të IGJK-së që kanë statusin e shërbyesit civil në akte të emërimit (pozita të karrierës**).**

- **Zhvillimi i procedurave të rekrutimit** - sipas ligjit dhe udhëzimeve administrative të shërbimit civil gjatë vitit 2011 janë zhvilluar disa procedura të rekrutimit, tri prej tyre me konkurs të hapur dhe dy me konkurs të brendshëm (avancime).

- **Trajnimi i stafit** - Në bashkëpunim me donatorët IGJK gjatë vitit 2011 ka realizuar trajnime me tema të veçanta dhe vizita studimore të rëndësishme për stafin e IGJK-së. Këto aktivitete janë prezantuar gjerësisht në pjesën e trajnimeve dhe vizitave

studimore të stafit. Stafi i IGJK-së kanë qenë edhe pjesë e trajnimeve për shërbyes civil të organizuara nga IKAP.

- **Zhvillimi i auditimit të brendshëm për personel-** - në mungesë të pozitës së auditorit të brendshëm, IGJK auditimin e brendshëm e realizoi nga auditorët e Ministrisë së Financave. Pjesë e këtij auditimit ishte menaxhimi dhe zhvillimi i personelit dhe burimeve njerëzore në IGJK për periudhën janar – dhjetor të vitit 2010. Qëllimi i auditimit ishte rishikimi i sistemeve të kontrollit, krijimi i kontrolleve në përputhje me rregullat dhe delegimin e funksioneve në pajtim me rregullat dhe procedurat ligjore për menaxhimin e personelit.

- **Transferi i web faqes së IGJK-së dhe Platformës E-learning** – Web faqja e IGJK-së si dhe platforma e-learning janë dizajnuar dhe financuar nga Programi i Binjakëzimit. Brenda vitit 2011 me kërkesë nga IGJK këto dy faqe zyrtare janë transferuar në domenin dhe në serverët e MAP-it.

- **Mbështetja nga donatorët me pajisje kompjuterike** - në saje të bashkëpunimit të mirë me GIZ në dhjetor të viti 2011 IGJK pranoi një donacion prej 20 llaptopëve të rinj. Mbështetja në këtë aspekt i mundëson IGJK-së krijimin e kushteve më të mira në shërbimin e teknologjisë informative. Këto pajisje janë dedikuar për kandidatët e rinj për gjyqtarë dhe prokurorë të PFAL.

- **Instalimi i pajisjeve nga E-Qeverisja -** me mbështetjen e MAP, departamenti i E-Qeverisjes, IGJK gjatë vitit 2011 ka instaluar pajisjet për E-Pasuri, E-Arkiva dhe programin GPS për kontrollim të automjeteve. Më këto shërbime janë krijuar kushte më të mira në menaxhimin e pasurisë, arkivit elektronik dhe transportit në IGJK.

- **Shërbimet e logjistikës** - në kuadër të shërbimeve të logjistikes përfshihen të gjitha furnizimet e bëra brenda kësaj periudhe si dhe shërbimet e ofruar të pastrimit, sigurimit dhe transportit.

## 14.2. Trajnimi i stafit të IGJK-së

IGJK në bashkëpunim me GIZ – "Projekti për Reformën Ligjore në Kosovë", gjatë vitit 2011 ka realizuar dy punëtori dy ditore ku përfitues ishin stafi i IGJK-së. Punëtoria e parë kishte të bëjë me zhvillimin e kurrikulave trajnuese të IGJK-së dhe është realizuar në muajin prill, ndërsa punëtoria e dytë po ashtu dy ditore është mbajtur në muajin dhjetor dhe kishte trajtuar temën "Hartimin e Raporteve dhe Shkresave Zyrtare". Qëllimi këtyre punëtorive ishte mbështetja e stafit të IGJK-së lidhur me hartimin dhe zhvillimin e programeve trajnuesve si dhe ngritja e aftësive praktike në shkrimin e raporteve dhe dokumenteve zyrtare.

Në kuadër të projektit "Drejtësi për Barazi Gjinore" i mbështetur nga UNWOMEN, në muajin shator 2011, IGJK realizoi një trajnim për stafin e vet me temë "Shkrimi i Propozim Projekteve, Ndërtimi i Ekipeve dhe Kreativiteti në Punë". Ndërsa po këtë muaj në mbështetje nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), IGJK realizoi një tryezë tjetër pune për stafin në të cilën u bë hartimi i disa udhëzimeve administrative të brendshme dhe

hartimi i Doracakut për Trajnues të IGJK-së. Këto dokumente do të kenë ndikim të drejtpërdrejtë në ngritjen e kapaciteteve të stafit për komunikim zyrtarë si dhe avancimin e metodologjisë së trajnimeve nga ana e trajnuesve të IGJK-së.



Foto 18. Trajnimi i stafit të IGJK-së

## 14.3. Prokurimi

Aktivitetet e prokurimit zhvillohen nga zyrtari i çertifikuar i prokurimit nën administrimin dhe mbikëqyrjen e Drejtorit për Administratë dhe Financa.

Gjatë vitit 2011 është realizuar në tërësi prokurimi sipas raportit vjetor të planifikuar për këtë vit, bazuar në Ligjin për Prokurim Publik. Sipas planifikimit vjetor të prokurimit në vitin 2011 janë zhvilluar disa procedura dhe janë nënshkruar 9 (nëntë) kontrata me kuotim të çmimeve, 12 (dymbëdhjetë) kontrata me vlerë minimale, 3 (tri) vazhdim kontrate dhe një aneks kontratë.

Në trajnimet e prokurimit të organizuara nga IKAP ishte pjesëmarrës edhe zyrtari i prokurimit nga IGJK.

## 14.4. Financat

Buxheti i ndarë për vitin 2011 ishte një ndër sfidat më të mëdha të IGJK-së për vitin 2011. Gjatë këtij viti shpenzimet e IGJK-së u mbuluan kryesisht nga Buxheti i Republikës së Kosovës si burim kryesor financiar, por një pjesë e shpenzimeve nga aktivitetet e IGJK-së u siguruan nga mbështetja e donatoreve. IGJK nuk ka llogari tjetër bankare përveç Llogarisë së Thesarit.

Gjatë vitit 2011 është zhvilluar një auditim i brendshëm i financave. Pjesë e këtij auditimi ishte menaxhimi i shpenzimeve për periudhën janar-dhjetor 2010. Qëllimi i këtij auditimi ishte rishikimi i efikasitetit të sistemeve të kontrollit të shpenzimeve, krijimi i kontrollit të brendshëm dhe delegimi i funksioneve për menaxhimin e shpenzimeve në pajtim me rregullat dhe procedurat ligjore.

Pavarësisht kërkesës buxhetore dhe nevojave kryesore të prezantuara në kërkesën buxhetore, me Ligjin për Buxhetin e Republikës se Kosovës për vitin 2011, IGJK-së ju ndan vetëm 512,515.00 euro. Këto mjete u ndanë për të gjitha kategoritë ekonomike përfshirë këtu pagat dhe mëditje, mallrat dhe shërbimet si dhe shpenzime komunale. Me rastin e miratimit të

kërkesës buxhetore të IGJK-së nuk u morën parasysh nevojat dhe kërkesa e prezantuara, me çka u rrezikua edhe realizimi i funksioneve ligjore të IGJK-së. Kështu që gjatë gjithë vitit 2011 kërkesa për mbështetje u adresua tek organet kompetente të vendit për ndarje shtese të buxhetit.

Reduktimet në fund të vitit të bëra nga qeveria nuk e kursyen as IGJK edhe përkundër faktit që ishin mjetet e fundit nga buxheti i mallrave dhe shërbimeve për tremujorin e fundit të vitit.

Tabela në vijim parqet buxhetin e IGJK-së për vitin 2011, duke përfshi ndryshimet e ndodhura në buxhet në fund të vitit

Ndarja e buxhetit gjatë vitit 2011 përfshinë katër kategori kryesore ekonomike: Pagat dhe Mëditjet, Mallra dhe Shërbime dhe Shpenzimet Komunale.

**Tab**. 3. Raporti i Buxheti për vitin 2011

| Pershkrimi | Buxheti Fillestar | vendimi 04/26 per reduktimin e alokimeve | Ndryshimi sipas nenit 29 ligji nr. 03/L-048 | Ndryshimi sipas nenit 30 ligji nr. 03/L-048 | Buxheti Perfundimtar |
|---|---|---|---|---|---|
| Pagat dhe Meditje | 143,349.00 | | | | 143,349.00 |
| Mallrat dhe Sherbimet | 352,766.00 | 21,166.00 | 105,100.00 | 2,458.00 | 439,158.00 |
| Shpenzimet Komunale | 16,400.00 | | | | 13,942.00 |
| **Totali** | **512,515.00** | **21,166.00** | **105,100.00** | **2,458.00** | **596,449.00** |

Ndryshimi në mes të buxhetit fillestar dhe atij përfundimtarë që pasqyrohet në tabelën 3 rrjedh pas vendimit nr. 04/26 të Qeverisë, me të cilin reduktohet buxheti i IGJK-së prej 6% në kategorinë e Mallrave dhe Shërbimeve, ndërsa me vendimin e Qeverisë nr. 06/49 i datës 23.11.2011 aprovohet kërkesa e Ministrisë se Drejtësisë për reduktimin dhe ndarjen e buxhetore nga programi - Administrata Qendrore në vlerë prej 105,100.00 euro për tu transferuar në buxhetin e IGJK-së si dhe transferi i mjeteve brenda kategorive ekonomike te buxhetit te IGJK-së bazuar ne LMFPP

Në vijim në mënyrë tabelare prezantohet ekzekutimi i buxhetit sipas kategorive ekonomike.

**Tab**. 4. Ekzekutimi i Buxhetit për vitin 2011

| Përshkrimi | Alokimet | Shpenzimet | Bilanci | Perqindja |
|---|---|---|---|---|
| Pagat dhe Meditjet | 143,349.00 | 132,413.00 | 10,936.00 | 92.37 |
| Mallrat dhe Shërbimet | 439,158.00 | 436,752.22 | 2,405.78 | 99.45 |
| Shpenzimet Komunale | 13,942.00 | 9,729.84 | 4,212.16 | 69.79 |
| **Taotali** | **596449** | **578895.06** | **17553.94** | **97.06** |

Shpenzimi i buxhetit për 97.06 % në përgjithësi paraqet një pasqyrë për një planifikim dhe menaxhim të mirë të buxhetit. Shpenzimi i mjeteve në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve për 99.45 % tregon qartë se gjatë vitit 2011, IGJK realizoi një numër të madh të aktiviteteve trajnuese. Shpenzimet komunale janë reduktuar për aq sa ishte e mundur, ndërsa pjesa e mbetur e mjeteve në paga dhe mëditje rrjedh si rezultat i lëvizjeve të bëra të stafit brenda këtij viti.

Një pjesë e shpenzimeve të dhjetorit do të barten si detyrime akruale në buxhetin e vitit 2012 për arsye të vet natyrës së shpenzimeve siç janë: shpenzimet komunale, shpenzimet e sigurimit, shpenzimet e trajnimit në fund të dhjetorit, etj.

Duke ju referuar tabelës 4, ekzekutimi i buxhetit, shtyllat me ngjyra të grafikonit në vijim prezantojnë mjetet e alokuara, të shpenzuara dhe bilancin për secilën kategori të mjeteve.




Grafikoni 18. Ekzekutimi i buxhetit

Kategoria e mallrave dhe shërbimeve në buxhetin e IGJK-së përshin shumën më të madhe të alokimeve, pasi që shërbimet e trajnimit janë pjesë e kësaj kategorie dhe janë shpenzimet kryesore të IGJK-së.

Grafikoni 19. Alokimi i mjeteve

Sipas grafikonit 19 Mallrat dhe Shërbimet përfshijnë shumën më të madhe të mjeteve të alokuara në krahasim me dy kategoritë tjera. Sipas trafikonit shihet se 74 % e buxheti ndahet për këtë kategori, 24 % për paga dhe mëditje dhe vetëm 2% për shpenzimet komunale.




Grafikoni 20. Shpenzimi i mjeteve

Shpenzimet e paraqitura në grafikonin 20 paraqesin akumulimin e mjeteve të shpenzuara nga tri kategoritë ekonomike. Pasi që IGJK është institucion kryesor për organizimin e trajnimeve në kuadër të programeve të ndryshme për arsimim ligjor, shpenzimet për shërbime të trajnimit janë shpenzimet kryesore në pasqyrat e shpenzimit të buxhetit.

Në tabelën në vazhdim në mënyrë të veçantë prezantohen shpenzimet e bëra gjatë vitit 2011.

**Tab**. 5. Shpenzimet për kategori dhe nën kategori ekonomike:

**Detalet e shpenzimeve për secilen kategori**

Shpenzimet janar-dhjetor 2011

| Numri i Llogarisë | Emri i Llogarisë | Shpenzimet | Alokimi | Bilanci |
|---|---|---|---|---|
| **Komunali** | | | | |
| 11140 | Komunali | - | 13.942,00 | 13.942,00 |
| 13230 | Mbeturinat | 1.218,00 | - | (1.218,00) |
| 13210 | Rryma | 3.788,52 | - | (3.788,52) |
| 13250 | Shpenzimet e telefonit | 4.183,80 | - | (4.183,80) |
| 13220 | Uji | 539,52 | - | (539,52) |
| **Shuma** | | **9.729,84** | **13.942,00** | **4.212,16** |
| **Mallrat dhe Shërbimet** | | | | |
| 13000 | Mallra dhe shërbime | - | 439.158,00 | 439.158,00 |
| 13140 | Shpenzimet e udhëtimit | 23.046,17 | - | (23.046,17) |
| 13300 | Shërbimet e telekomunikimit | 5.916,20 | - | (5.916,20) |
| 13400 | Shpenzimet për shërbimet/trajnimit | 254.619,77 | - | (254.619,77) |
| 13500 | Mobilie dhe pajisje më pak se 100 euro | 1.355,00 | - | (1.355,00) |
| 13600 | Blerje tjera të mallrave dhe shërbimeve | 26.495,89 | - | (26.495,89) |
| 13700 | Derivate dhe lëndë djegëse | 19.545,42 | - | (19.545,42) |
| 13950 | Shërbimet e regjistrimit dhe sigurimit | 12.307,40 | - | (12.307,40) |
| 14000 | Mirëmbajtja | 8.234,03 | - | (8.234,03) |
| 14110 | Qiraja | 64.951,92 | - | (64.951,92) |
| 14200 | Shpenzimet e marketingut | 19.664,19 | - | (19.664,19) |
| 14300 | Shpenzimet e përfaqësimit | 616,23 | - | (616,23) |
| **Shuma** | | **€ 436.752,22** | **€ 439.158,00** | **€ 2.405,78** |
| **Pagat** | | | | |
| 11000 | Pagat | - | 143.349,00 | 143.349,00 |
| 11110 | Pagat neto | 113.084,78 | - | (113.084,78) |
| 11120 | Tatimi i ndalur në të ardhura | 6.718,14 | - | (6.718,14) |
| 11130 | Kontributi i punëtorit | 6.305,04 | - | (6.305,04) |
| 11140 | Kontributi i punëdhënësit | 6.305,04 | - | (6.305,04) |
| **Shuma** | | **€ 132.413,00** | **€ 143.349,00** | **€ 10.936,00** |
| **Totali** | | **578.895,06** | **596.449,00** | **17.553,94** |

Tabela 5 përmban pasqyrimin e duhur për të gjitha shpenzimet e krijuara gjatë vitit 2011. Në kuadër të pagave përfshihet edhe kompensimi për anëtarët e Këshillit Drejtues të IGJK-së.




Grafikoni 21. Shpenzimet sipas përqindjes së realizuar

Në grafikonin 21 - shpenzimet sipas përqindjes së realizuar, prezantohet shpenzimi i mjeteve për secilën kategori në raport me totalin e buxhetit. Shërbimet e trajnimit përfshihen me përqindje më të lartë prej 45.10% e buxhetit. Arsye për këtë përqindje të shpenzimeve është aktivitetet e shumta të realizuara në këtë vit, ndërsa shpenzimet me përqindjen me të vogël të buxhetit janë shpenzimet e përfaqësimit me 0.11%.

Me përjashtim të shpenzimeve për shërbimet e trajnimit shpenzimet tjera operative në krahasim me vitin e kaluar shënojnë një rënie, përfshirë këtu edhe shpenzimet e qirasë dhe të sigurimit.

Të gjitha pagesat e bëra nga mjetet e ndara nga Buxheti i Republikës se Kosovës për IGJK-në janë regjistruar në Sistemin Informativ Financiar (free balance) si dhe në bazën e të dhënave financiare të IGJK-së.

Përveç këtij raporti të shkurtër financiar ekzistojnë edhe pasqyrat financiare vjetore që përmbajnë detaje për secilin shpenzim të bërë në të gjitha kategoritë ekonomike.

## 14.5. Mbështetja financiare nga Donatorët

Edhe gjatë viti 2011 IGJK gëzoi mbështetje të madhe financiare nga donatorë të ndryshëm si US DoJ (OPDAT), UNDP, ECLO (Programi i Binjakëzimit), UNICEF, GIZ, UNWOMEN, USAID (Checchi, SEAD, NCSC), OSBE, OSBE-ODIHR, IRZ, CLARD, Shoqata e Banave të Kosovës.

**Tab.** 6. Donacionet përmes llogarisë së Thesarit

| Emri I Donatorit | Shpenzimet | Alokimet | Bilanci |
|---|---|---|---|
| UNICEF | € | € | € |
| | 13,148.54 | 13,657.90 | 509.36 |
| **Totali në -UNICEF** | **13,148.54** | **13,657.90** | **509.36** |
| UNWomen | | | |
| | 11,733.49 | 11,734.00 | 0.51 |
| **Totali në -UNWomen** | **11,733.49** | **11,734.00** | **0.51** |
| **Totali i donacionit** | **24,882.03** | **25,391.90** | **509.87** |

Tabela 6 pasqyron grantet e donatorëve që kanë rrjedhë përmes llogarisë së thesarit dhe që janë menaxhuara nga IGJK. Shpenzimet e mbuluara nga këto dy projekte janë kryesisht shpenzimet e trajnimit, shpenzimet e botimeve dhe publikimeve, shpenzimet e përkthimit, paga e këshilltarit vendor, material shpenzues për trajnime etj. Të gjitha transaksionet e realizuar janë të regjistruara edhe në SIMFK

Tabela ne vijim prezanton mbështetjen e donatoreve tjerë dhe te rëndësishëm për IGJK dhe të cilët kanë ofruar të dhëna financiare.

**Tab**. 7. Donacionet të menaxhuar nga vet donatorët

| | |
|---|---|
| UNDP | 251,716.80 |
| NITA | 25,603.41 |
| Twining | 143,412.00 |
| Shoqata e Bankave të kosoves | 120.00 |
| OSBE | 2,960.00 |
| OSBE/ODIHR | 1,189.00 |
| GIZ | 130,000.00 |
| CLARD | 1,550.55 |
| USAID/SEAD | 25,000.00 |
| Totali në euro | 329,834.96 |
| Totali ne $ | 251,716.80 |

Nga tabela 7 prezantohen donacionet e menaxhuara nga vet donatorët duke ju referuar informatave të ofruara nga donatoret, çka do të thotë se këto mjete nuk kanë rrjedhë përmes llogarisë së thesarit. Në këtë tabelë bëhet paraqitja e mbështetjes nga donatoret vetëm në totalin e shpenzimeve pa pasur mundësi të jepen detaje financiare për të gjitha donacionet meqë menaxhimi i buxhetit dhe shpenzimeve është bërë nga vet donatorët.

Prezantimi dhe shpalosja e donacioneve në këtë rast tregon çart se IGJK ka mundur të realizoj një numër të aktiviteteve për këtë vit edhe falë mbështetjes që e kanë ofruar donatorët. Edhe pse nuk janë të specifikuara dhe detajuara, shpenzimet e mbuluara nga donatorët kanë qenë kryesisht shpenzime për shërbimet e trajnimit, një pjesë e honorarit të kandidateve, shpenzime

për botime e publikime, shpenzime për ceremoninë e diplomimit të kandidatëve, dhe shpenzime për pajisje të teknologjisë informative.

## 14.6. Bashkëpunimi me donatorë

Në mbështetje të partnerëve ndërkombëtarë, IGJK ka vazhduar të ofrojë mundësi të ndryshme të ngritjes profesionale për gjyqtarë, prokurorë, kandidat për gjyqtarë dhe prokurorë si dhe profesionist tjerë nga lëmi i gjyqësisë dhe prokurorisë. Në disa raste përfitues i kësaj mbështetjeje ishte edhe stafi i IGJK-së.

Kjo mbështetje e donatorëve është shprehur në programe dhe aktivitete të ndryshme të cilat po i pasqyrojmë si më poshtë:

| Nr | **Partnerët dhe donatorët vendor e ndërkombëtarë** | **Aktiviteti** |
|---|---|---|
| 1 | UNDP | ▪ Mbështetje financiare për PFAL (publikimi i materialeve të ndryshme, pagesa e një pjese të honorarit për kandidatët për gjyqtarë dhe prokurorë dhe pagesa e një shujte);<br>▪ Organizimin e tryezës për Hartimin dhe Vlerësimin e Provimit Përgatitor/Hyrës për gjeneratën e katërt të kandidatëve për gjyqtarë dhe prokurorë;<br>▪ Mbështetjen me ekspertizë të PFAL (disa module);<br>▪ Trajnim dy ditorë i nivelit të avancuar për trajnues të IGJK në kuadër të PVAL;<br>▪ Organizimi i tryezës së punës për stafin e IGJK-së për hartimin e dokumenteve të brendshme;<br>▪ Mbështetje në përkthime në të gjitha aktivitetet programore;<br>▪ Mbështetje për organizimin e ceremonisë së diplomimit të kandidatëve të ILEP (gjenerata e tretë). |
| 2 | US/DoJ/OPDAT | • Katër trajnime tre ditore me temë Ndërtimi i Shkathtësive të Përfaqësimit gjatë Gjykimit në PVAL;<br>• Dy trajnime tre ditore me temë Ndërtimi i Shkathtësive të Përfaqësimit gjatë Gjykimit në kuadër të PTA;<br>• Një trajnim tre ditor me temë Ndërtimi i Shkathtësive të Përfaqësimit gjatë Gjykimit në PFAL;<br>• Konferenca për javën e mbrojtjes së viktimave të trafikimit;<br>• Mbështetje me ekspertizë në lëmin e krimit financiar, në kuadër të PFAL. |
| 3 | USAID/CHECCHI | • Vlerësimi i Programit të Vazhdueshëm për Arsimim Ligjor |

| | | |
|---|---|---|
| | | • Vlerësimi i Programit Fillestar për Arsimim Ligjor (në proces) |
| 4 | USAID/SEAD | ▪ Standardet Ndërkombëtare në Procedurën e Ekzekutimit;<br>▪ Kontratat mbi Ndërtimin;<br>▪ Ligji mbi Ndërmjetësimin;<br>▪ Procedura e Ekzekutimit pjesa e II;<br>▪ Kontratat për licencën, linzingun, magazinimin dhe kontrollin e mallit;<br>▪ Kontrata mbi Kredinë;<br>▪ Arbitrazhi;<br>▪ Konventa e OKB-së për Kontratën për Shitjen Ndërkombëtare të Mallrave.<br><br>Për zyrtarët përmbarimorë janë realizuar shtatë (7) sesione trajnuese në modulet si me poshtë:<br>▪ Hyrje në Përmbarim;<br>▪ Komunikimi me shkrim;<br>▪ Kodi i Etikës për Personelin Administrativ të Gjykatave;<br>▪ Masat Përmbarimore/pjesa e I;<br>▪ Masat Përmbarimore/pjesa e II;<br>▪ Iniciativa për zvogëlimin e lëndëve të vjetra të grumbulluara. |
| 5 | USAID/NCSC | ▪ Dy sesione trajnuese regjionale me temë Menaxhimi i Rasteve. |
| 6 | OSBE | OSBE ka ofruar mbështetjen si më poshtë:<br>• Vëzhgues për Provimin Përgatitor dhe të gjitha provimet e organizuara në PFAL;<br>• Përmbledhje të ligjeve dhe raporte të ndryshme (PFAL)<br>▪ Sesion tre ditor Trajnimi për Trajnues të nivelit bazik;<br>▪ Seminar për Vendimet Gjyqësore dhe Veprimet Kadastrale;<br>▪ Seminar Ligji mbi Shpronësimin;<br>▪ Seminar dy ditor të ndarë në 4 grupe për bashkëpunëtor profesional;<br>▪ Seminar dy ditorë për gjyqtarë dhe prokurorë, lidhur me dënimin e çështjeve për krime të luftës me fokus në Krimet e Luftës dhe Llojet e Përgjegjësive,<br>▪ Vizitë studimore në Tribunalin e Hagës (ICTY);<br>▪ Tryezë diskutimesh një ditore Ligji për Pronësinë dhe të drejtat tjera sendore -Fitimi dhe humbja e pronësisë;<br>▪ Seminar Ndjekja e Krimeve të Urrejtjes;<br>▪ Konferenca Vjetore Gjyqësore, e mbajtur në bashkëpunim me Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Gjykatën Supreme të Kosovës dhe Institutin Gjyqësor |

| | | |
|---|---|---|
| | | të Kosovës.<br>▪ Këshilltar Special (me qëndrim të përhershëm në IGJK) i cili përveç ofrimit të këshillave të përditshme për stafin menagjues të IGJK-së, ka mbështetur me ekspertizë tri trajnime për trajnuesit e IGJK-së, dy trajnime për stafin e IGJK-së. Ky këshilltar në bashkëpunim me stafin ka realizuar udhëzuesin për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje, doracakun për trajnuesit e IGJK-së dhe ka ndihmuar në zhvillimin e moduleve të reja të IGJK-së bazuar në çështjet e identifikuara në raportet e OSBE (LSMS). |
| 7 | Komisioni Evropian Programin e Binjakëzimit (Twinning EU LER) | ▪ Trajnimi i gjyqtarëve, prokurorëve dhe profesionistëve tjerë nga lëmi i gjyqësisë lidhur me të Drejtën e BE-së;<br>▪ Trajnim i trajnuesve të IGJK-së nga e Drejta e BE-së;<br>▪ Hartim të doracakëve të ndryshëm nga lëmia penale, civile dhe E Drejta e BE-së,<br>▪ Vizitë studimore për stafin e IGJK-së në Akademinë Gjyqësore të Gjermanisë dhe Akademinë Evropiane (ERA) në Trier.<br>▪ Vizitë studimore për Këshillin Drejtues të IGJK-së në Shkollën e magjistraturës në Bordo (Francë).<br>▪ Krijimi dhe funksionalizimi i Portalit e-learnig/ programi i mësimit në distancë;<br>▪ Trajnimi i stafit udhëheqës dhe trajnuesve të përhershëm të IGJK-së lidhur me Programin e-learning;<br>▪ Mbështetje në përkthim në të gjitha aktivitetet e realizuara me IGJK-në;<br>▪ Publikimi i Doracakut për Trajnues në Fushën e së Drejtës së BE-së si dhe<br>▪ Moduli Trajnues për të Drejtën e BE-së. |
| 8 | GIZ | ▪ Punëtori dy ditore për stafin e IGJK-së lidhur me zhvillimin e kurrikulave trajnuese;<br>▪ Punëtori dy ditore për stafin e IGJK-së për hartimin e raporteve dhe shkresave zyrtare;<br>▪ Vlerësimi i fazës së tretë të PFAL;<br>▪ Hartimi i draft Doracakut për Mentorët e kandidatëve të PFAL;<br>▪ Mbështetje me 20 laptopë për kandidatët e PFAL, për shfrytëzim gjatë fazës praktike në gjykata dhe prokurori. |
| | | ▪ Një trajnim për trajnues tre ditor me temën “Barazia Gjinore dhe të Drejtat e Njeriut”;<br>▪ Pesë tryeza diskutimesh në të cilat trajnerët e çertifikuar për këtë qëllim nga IGJK dhe UNWOMEN, për herë të parë zhvilluan trajnime nga fusha e të Drejtave të njeriut me temë: Dhuna në Familje, |

| | | |
|---|---|---|
| 9 | UN Women | Standardet Ndërkombëtare dhe Ligji për Barazinë Gjinore, të Drejtat e Fëmijëve dhe Trafikimi me Qenie Njerëzore, me karakter regjional;<br>▪ Punëtori për trajnimin e stafit të IGJK-së me temë "Shkrimi i projekt propozimeve, ndërtimi i punës ekipore dhe kreativiteti në punë"; dhe<br>▪ Publikimi i Udhëzuesit për Mbrojtjen e Viktimave të Dhunës në Familje, i cili u dedikohet viktimave të dhunës në familje, gjyqtarëve, prokurorëve, zyrtarëve të policisë, shoqërisë civile, si dhe institucioneve tjera nga kjo fushë. |
| 10 | Akademia Gjyqësore e Turqisë dhe TIKA | Realizimi i programit trajnues dhe vizitës studimore në Akademinë Gjyqësor të Turqisë dhe institucionet tjera të sistemit gjyqësor e prokurorial për kandidatët e PFAL dhe stafin e IGJK-së. |
| 11 | Deutsche Stiftung für International Rechtliche Zusamenarbeit (IRZ) | Pjesëmarrje në Konferencën regjionale me temë " E ardhmja e trajnimit fillestar dhe të vazhdueshëm për gjyqtarët dhe prokurorët e rinj - Situata aktuale, perspektiva në të ardhmen dhe objektivat" |
| 13 | QKSPEZH (Vushtri) | Mbështetja me salla, personel dhe objekte mbështetëse për realizim të Provimit Përgatitor/Hyrës për kandidatët për gjyqtarë dhe prokurorë. |
| 15 | Këshilli Gjyqësor i Kosovës | Pagesa e një pjese të honorarit të disa kandidatëve të PFAL |
| 16 | Këshilli Prokurorial i Kosovës | Pagesa e një pjese të honorarit të disa kandidatëve të PFAL |
| 17 | Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës | Alokimi i 105.100,00 Euro nga buxheti i ministrisë në buxhetin e IGJK-së |
| 18 | Asambleja e Gjyqtarëve të EULEX-it | Një tryezë diskutimesh nga e drejta penale me temë "Praktikat e Dënimeve". Në këtë tryezë u diskutuan çështjet rreth praktikës së dënimeve në Kosovë me qëllim të unifikimit të saj nga gjyqtarët vendorë dhe ndërkombëtarë. |
| | | ▪ Punëtori me temë "Programi i Trajnimit për Trajner në fushën e Drejtësisë për të Mitur;<br>▪ Një tryezë pune me trajnuesit e lëmisë për të mitur, me |

| | | |
|---|---|---|
| 19 | UNICEF | qëllim të hartimit të draft modulit nga Kodi i Drejtësisë për të Mitur;<br>▪ Pesë tryeza pune me temë "Kodi i Drejtësisë për të Mitur", me karakter regjional, dhe<br>▪ "Konferenca Vjetore e Drejtësisë për të Mitur", në të cilën u diskutuan sfidat dhe problemet kryesore të shfaqura gjatë zbatimit të ligjshmërisë në fushën e drejtësisë për të mitur në Kosovë. |
| 20 | Qendra Evropiane për Çështje të Minoriteteve (ECMI) dhe Qendra për Ndihmë Juridike dhe Zhvillim Regjional (CLARD) | Tryezë diskutimesh me temë "Standardet ndërkombëtare kundër dhunës në familje, Ligji Kundër Diskriminimit, dhe çështjet pronësore". |
| 21 | Shoqata e Bankave të Kosovës | Tryeza e diskutimeve me temë "Lufta Kundër Krimit Kibernetikë" ku u diskutuan problemet praktike gjatë procedimit të transaksioneve financiare, veçoritë dhe siguria e kartelave bankare, mashtrimet/keqpërdorimet në pikat shitëse, keqpërdorimet përmes internetit etj. |

## 15. Publikimet e IGJK-së

Në gjashtëmujorin e parë të vitit 2011, IGJK-ja ka zhvilluar disa publikime të cilat do t'i prezantojmë më poshtë:

- **Revista " Justicia"** - Kandidatët për gjyqtarë dhe prokurorë në kuadër të PFAL, në bashkëpunim me IGJK kanë përgatitur revistën shkencore "Justicia" e cila përmban hulumtime shkencore nga fusha e drejtësisë. Numri i tretë i kësaj reviste është publikuar në tetor 2011 ditën e diplomimit të këtyre kandidatëve.

- **Manual për ToT nga e Drejta e BE-së –** gjatë vitit 2011 ekspertet ndërkombëtare të Programit të Binjakëzimit, kanë ofruar mbështetje me ekspertizë ligjore në kuadër të së drejtës së BE-së, dhe njëkohësisht kanë përgatitur një manual për trajnuesit e IGJK-së për të Drejtën e Unionit Evropian.

- **Broshurat** – IGJK, ka publikuar një format të ri të broshurës për vitin 2011 në të cilën janë prezantuar të dhënat për aktivitetet e Institutit.

- **Buletini** – Gjatë vitit 2011 është vazhduar me publikimin e buletinit mujor në të cilin prezantohen aktivitetet e realizuara gjatë një muaji, duke përfshirë të gjitha ngjarjet në IGJK. Janë publikuar 9 numra të buletinit dhe atë në gjuhen shqipe, serbe dhe angleze.

- **Modulet trajnuese –** Janë përmbledhje e kurseve trajnuese të përgatitura nga trajnuesit e IGJK për programet PFAL dhe PTA. Gjatë vitit 2011 janë publikuar 54 module me përmbajtje të aprovuar në programin e trajnimeve.
- **Raport-“Drejtësia për të Mitur në Kosovë” –** IGJK në bashkëpunim me UNICEF, mbështetur nga Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian zyra në Kosovë, ka publikuar një raport në kuadër të projektit “Mbështetje e reformave të Drejtësisë për të Mitur në Kosovë”. Ky raport përfshin konkluzione dhe rekomandime për institucionet relevante në këtë fushë.
- **Udhërrëfyes për Mbrojtjen e Viktimave të Dhunës në Familje –** Në dhjetor 2011, IGJK, në mbështetje të Projektit të Drejtësisë Për Barazi Gjinore (UNWOMEN) në Kosovë, promovuan udhërrëfyesin për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje. Qëllimi i këtij udhërrëfyesi është që t’iu ofrojë viktimave të dhunës në familje informata se si të kërkojnë ndihmë kur ato përjetojnë dhunë në familje. Ky udhërrëfyes paraqet rolin e qeverisë, policisë, gjyqtarëve, prokurorëve, shoqërisë civile dhe akterëve të tjerë të cilët punojnë në asistimin e viktimave të dhunës në familje. Udhërrëfyesi gjithashtu ofron informata esenciale rreth ligjeve me të cilat rregullohen rastet e dhunës në familje si dhe procedurat ligjore për mbrojtjen e viktimave të kësaj.

- **Web Faqja –** Edhe në këtë periudhë ka vazhduar publikimi i informacioneve dhe materialeve të ndryshme në web faqen e IGJK-së.




Foto 20. Web faqja e IGJK-së




Foto 21. Udhëzuesi për dhunën në familje

## 16. Mësimi në distancë / e - learning

IGJK me mbështetje të Programit të Binjakëzimit (Reforma e Sistemit për Arsimim Ligjor) i cili financohet nga fonde të BE-së dhe menaxhohen nga Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian, ka krijuar dhe bërë funksional portalin e mësimit në distancë (portali e-learning). Përmes këtij programi IGJK ofron edhe mundësi për arsimimin ligjor me një metodologji dhe sistem mjaftë të avancuar. Ky program u mundëson gjyqtarëve, prokurorëve dhe përfituesve të tjerë të identifikuar nga IGJK, ndjekjen e kurseve të veçanta trajnuese në varësi të agjendës së tyre dhe pa pasur nevojë të jenë fizikisht në vendin ku mbahet trajnimi.




Foto 22. Platforma e-learning

# 17. Bashkëpunimi Ndërkombëtar dhe Vizitat Studimore

## 17.1. Shkolla Kombëtare e Magjistraturës në Bordo të Francës

IGJK, në bashkëpunim me Programin e Binjakëzimit, në muajin maj 2011 ka organizuar një vizitë pesë ditore në Shkollën Kombëtare të Magjistraturës në Bordo të Francës si dhe në Gjykatën e Qarkut dhe të Apelit. Delegacioni ishte i përbërë nga anëtarët e Këshilli Drejtues, anëtarët e Këshillit Programor dhe stafi i IGJK-së, Kryeprokurori i Shtetit dhe këshilltarja speciale e OSBE-së në IGJK.




Foto 23. Vizita studimore në Shkollën Kombëtare të Magjistraturës në Bordo të Francës

Qëllimi i kësaj vizite ishte njohja me organizimin dhe funksionimi i shkollës, programet që i realizon, përgatitjen e plan programeve, procedurën për rekrutimin e kandidatëve për të qenë pjesë e programit të trajnimit fillestar, mënyrën e vlerësimit dhe të monitorimit të kandidatëve për gjyqtarë dhe prokurorët të rinj.

Gjatë kësaj vizite Këshilli Drejtues dhe Këshilli Programor i IGJK-së mbajtën një mbledhje të rregullt në të cilën propozuan hapa konkret që duhet të ndërmarrë IGJK për avancimin e punës, duke përfshi këtu edhe nevojën që IGJK të transformohet në Akademi Gjyqësore ose Shkollë të Magjistraturës. Si përfundim i kësaj mbledhjeje u miratua “Platforma Strategjike për Zhvillimin dhe Transformimin e IGJK-së”.

## 17.2. Akademia Gjyqësore e Gjermanisë dhe Akademia Evropiane e Drejtësisë në Trier

IGJK, në bashkëpunim me Programin e Binjakëzimit, në muajin mars 2011 ka organizuar një vizitë në Akademinë Gjyqësore të Gjermanisë dhe Akademinë Evropiane të Drejtësisë në Gjermani (Trier). Delegacioni ishte i përbërë nga stafi udhëheqës dhe profesional i IGJK.



Foto 24. Vizita studimore në Akademinë Gjyqësore në Gjermani (Trier)

Qëllimi i kësaj vizite ishte njohja me sistemin gjyqësor të Gjermanisë dhe mënyrën e organizimit dhe funksionimit të programeve trajnuese të Akademisë Gjyqësore Gjermane dhe Akademisë Evropiane të Drejtësisë.

## 17.3. Konferencë ndërkombëtare - “Gjyqtari/Prokurori Vendor dhe Evropian - Roli i Qendrave për Trajnim Profesional”

Me 7 dhe 8 prill, në Zagreb të Republikës së Kroacisë është zhvilluar konferenca ndërkombëtare dy ditore me temë “Gjyqtari/Prokurori Vendor dhe Evropian - Roli i Qendrave për Trajnim Profesional”. Programi i konferencës kishte për diskutim temat, si: Mësimi për të Drejtën e BE-së, Mësimi në Distancë (e-learning) dhe Trajnimi i Trajnuesve për të drejtën e BE-së.

Si rezultat i kësaj konference u nënshkrua Marrëveshja për Bashkëpunim Multilateral në aspektin regjional në fushën e trajnimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Këtë marrëveshje e nënshkruan përfaqësues të institucioneve të trajnimit nga: Polonia, Hungaria, Sllovenia, Bosna e Hercegovina, Mali i Zi, Kosova, Maqedonia, Kroacia dhe Sllovakia.

## 17.4. Punëtori Regjionale për Trajnime Gjyqësore *“Bashkëpunimi Regjional në të Drejtën Penale-Ngritja e kapaciteteve për luftimin e krimeve kibernetikë”*

Me 11 dhe 12 maj, në mbështetje të Programit Regjional IPA, projektit për Bashkëpunimin Regjional në të Drejtën Penale, financuar nga Komisioni Evropian dhe implementuar nga Këshilli i Evropës, në Ohër të Republikës së Maqedonisë, është organizuar punëtoria regjionale dy ditore, që kishte për qëllim “Ngritjen e kapaciteteve në luftën kundër krimeve kibernetike. Në këtë punëtori morën pjesë delegacione nga: Shqipëria, Turqia, Kroacia, Mali i Zi, Kosova, Bosnja dhe Hercegovinë, Serbia dhe Maqedonia.

Qëllimi i punëtorisë ishte inkorporimi i trajnimeve lidhur me “krimet kibernetike dhe provat elektronike” në kurrikulat e institucioneve trajnuese për gjyqtarë dhe prokurorë, zhvillimi dhe hartimi i moduleve trajnues, zhvillimi i pilot trajnimeve nga kjo lëmi si dhe themelimi i së paku një pilot qendre në rajon, gjë që u vendos të themelohet  në Republikën e Kroacisë.

## 17.5. Vizita në Shkollën e Magjistraturës së Republikës së Shqipërisë

Me ftesë të Shkollës së Magjistraturës së Republikës së Shqipërisë nga data 12-14 shtator një delegacion nga IGJK ka realizuar një vizitë pune.

Qëllimi i vizitës ka qenë ngritja e nivelit të koordinimit dhe bashkëpunimit për realizim të aktiviteteve trajnuese, kryesisht në realizimin e provimit për pranimin e kandidatëve të rinj për gjyqtarë dhe prokurorë në Programin Fillestar për Arsimim Ligjor. Me këtë rast delegacioni i IGJK-së, përveç takimeve u angazhuan në cilësi të monitoruesve në procesin e provimit pranues të magjistratëve në Shkollën e Magjistraturës. Nga ky proces IGJK nxori edhe disa rekomandime lidhur me avancimin e procesit të Provimit Përgatitor për kandidatët e PFAL në IGJK.

## 17.6. Konferenca e 5-të Ndërkombëtare për Trajnime Gjyqësore *Tema:”Trajnimi gjyqësor në botën e globalizuar-rikthimi i besimit dhe stabilitetit”*

Duke filluar nga 31 tetor deri më 3 nëntor 2011, Shkolla Kombëtare Franceze për Gjyqësorin (ENM) ka mbajtur Konferencën e 5-të Ndërkombëtare për Trajnimin Gjyqësor, në Bordo-Francë.

Në këtë konferencë nga njëqind shtete, 300 pjesëmarrës dhe folës morën pjesë në rreth njëzet seminare, tryeza dhe seanca plenare. Pjesëmarrësit gjatë katër ditëve debatuan mbi efikasitetin, legjitimitetin dhe solidaritetin e trajnimit gjyqësor ndërkombëtarë. Në këtë Konferencë IGJK është përfaqësuar nga Drejtori i IGJK-së.

## 17.7. Konferenca Regjionale “E ardhmja e trajnimit fillestar dhe të vazhdueshëm për gjyqtarët dhe prokurorët e rinj - Situata aktuale, perspektiva në të ardhmen dhe objektivat”

Nën organizimin e Akademisë për Gjyqtarë dhe Prokurorë të Maqedonisë dhe Fondacionit Gjerman për Bashkëpunim Ndërkombëtarë (IRZ), nga 21 deri 23 nëntor 2011, në Shkup u mbajt Konferenca Regjionale me temë “E ardhmja e trajnimit fillestar dhe të vazhdueshëm për gjyqtarët dhe prokurorët e rinj - Situata aktuale, perspektiva në të ardhmen dhe objektivat”.

Në këtë konferencë morën pjesë përfaqësues të institucioneve trajnuese të regjionit dhe më gjerë, të cilat prezantuan situatën aktuale, vështirësitë, sfidat dhe objektivat që kanë këto institucione në ndërtimin e programeve trajnuese për arsimim ligjor për gjyqtarët dhe prokurorët. Fokusi kryesor i kësaj konference ishte programi trajnues për përgatitjen e kandidatëve për gjyqtarë dhe prokurorë të ardhshëm si dhe programet special trajnuese për këta kandidatë pas emërimit të tyre.

Instituti Gjyqësor i Kosovës në këtë konferencë u përfaqësua nga Drejtori i IGJK-së dhe udhëheqësi i Programit Fillestar për Arsimim Ligjor.

### 17.8. Vizita studimore në Tribunalin Ndërkombëtar në Hagë (ICTY)

Më 5 dhe 6 tetor 2011 u realizuan një vizitë studimore në Tribunalin Ndërkombëtar për Krime të Luftës (ICTY) në Hagë të Holandës. Kjo vizitë është realizuar në kuadër të Projektit për Drejtësi për Krime të Luftës i BE-së, zbatuar nga OSBE, Zyra për Institucione dhe të Drejta të Njeriut (ODIHR), në bashkëpunim me IGJK-në, Tribunalin e Hagës dhe Institutin Kërkimor Ndër-rajonal për Krime dhe Drejtësi i OKB-së (UNICRI).

Qëllimi i vizitës ishte fuqizimi i bashkëpunimit me Tribunalin e Hagës si dhe shkëmbimi i pikëpamjeve dhe ekspertizës me gjyqtarët dhe prokurorët e Kosovës në lidhje me gjykimin e rasteve lidhur me krimet e luftës. Në kuadër të vizitës u realizua një tryezë diskutimesh me gjyqtarët dhe prokurorët e Tribunalit të Hagës, si dhe prezantime nga stafi i Tribunalit.

Temat të diskutimeve me këtë rast ishin: mbrojta e dëshmitarëve, hartimi i aktgjykimit dhe aktakuzës, sfidat lidhur me gjykimin e krimeve të luftës, mjetet procedurale për përshpejtimin e procedurës lidhur me krimet e luftës si dhe qasja në bazën e të dhënave dhe dokumentet ligjore të Tribunalit.

Përfitues të kësaj vizite ishin kryetarë dhe gjyqtarë të gjykatave të qarkut, prokurorë nga prokuroria e qarkut, Prokuroria e Shtetit dhe Prokuroria Speciale si dhe stafi udhëheqës i IGJK-së.

## 18. Programi për praktikant-studentë të Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës

Gjatë vitit 2011 IGJK në bashkëpunim me Qendrën për Shërbime të Karrierës të Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës e mbështetur nga ABA/ROOLI, ka ofruar mundësi për punë praktike për 9 studentë të Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës.

Qëllimi i projektit është që studentëve të ju mundësohet ofrimi i njohurive praktike në kuadër të programeve të IGJK-së. Përfitues të këtij programi janë studentët e vitit të tretë të nivelit bachelor apo vitit të katërt me sistem katërvjeçar. Përfitimet nga ky projekt janë të dyanshme ngase përveç ngritjes së kapaciteteve të studentëve, IGJK ka arritur të përfitojë mbështetje gjatë organizimit të aktiviteteve të ndryshme.

# 19. Anekset

## 19.1. Aneksi I – Aktivitetet trajnuese - PVAL Janar - Dhjetor 2011

| Muaji | Nr | Tema | Kohëzgjatja | Fusha | Financimi |
|---|---|---|---|---|---|
| **Janar** | 1 | Ndërtimi i Shkathtësive të përfaqësimit gjatë Gjykimit | 3 ditor | Penale Specializuara | IGJK/US DOJ |
| | 2 | Procedura e Adoptimit të Fëmijëve | 1 ditor | civile | IGJK |
| | 3 | Autorizimet e Prokurorit të Shtetit | 1 ditor | penale | IGJK |
| **Shkurt** | 4 | Fillimi dhe kohëzgjatja e hetimeve | 1 ditor | penale | IGJK |
| | 5 | Risitë e Ligjit për Punën | 1 ditor | civile | IGJK |
| | 6 | Juridiksioni i gjykatave në kontestet pronësore | 1 ditor | civile | IGJK |
| | **7** | Konfirmimi i aktakuzës | 1 ditor | penale | IGJK |
| | 8 | Kundërvajtjet kundër rendit dhe qetësisë publike | 1 ditor | kundërvajtje | IGJK |
| | 9 | Hartimi dhe arsyetimi i vendimeve gjyqësore | 1 ditor | civile | IGJK |
| | 10 | Trashëgimtarët e domosdoshëm | 1 ditor | civile | IGJK |
| | 11 | Krimi i organizuar | 1 ditor | penale | IGJK |
| | 12 | Standardet ndërkombëtare në procedurën e ekzekutimit | 1 ditor | penale | IGJK |
| | 13 | Parimet e përgjithshme të Kodit të Etikës për gjyqtarë, prokurorë dhe gjyqtarë porotë | 1 ditor | Të tjera | IGJK |
| **Mars** | 14 | Konflikti Administrativ | 1 ditor | adminis. | IGJK |
| | 15 | Ligji për Ndërmjetësimin | 1 ditor | penale | IGJK |
| | 16 | Trafikimi me narkotikë të rrezikshëm dhe substanca psikotrope | 1 ditor | penale | IGJK |
| | 17 | Ndërtimi i Shkathtësive të Përfaqësimit Gjatë Gjykimit | 3 ditor | penale | IGJK/US DOJ |
| | 18 | Mbrojtja nga dhuna në familje | 1 ditor | civile | IGJK |
| | 19 | Kontrata për ndërtimin | 1 ditor | civile | IGJK/SEAD |
| | 20 | Masat dhe dënimet alternative ndaj të miturve-Risitë e Kodit të Drejtësisë për të Mitur | 1 ditor | tjera | IGJK/UNICEF |
| | 21 | Ligji për procedurën kontestimore | 1 ditor | civile | IGJK |
| | 22 | E drejta për liri dhe siguri | 1 ditor | penale | IGJK |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | 23 | Të miturit si kryes të veprave kundërvajtëse | 1 ditor | tjera | IGJK |
| **Prill** | 24 | E drejta Evropiane në praktikë | 5 ditor | civile | IGJK/Twining |
| | 25 | Korrupsioni | 1 ditor | penale | IGJK |
| | 26 | Dëshmitarët në procedurën penale | 1 ditor | penale | IGJK |
| | 27 | Masat e fshehta teknike të hetimit dhe vëzhgimit | 1 ditor | penale | IGJK |
| **Maj** | 28 | Vendimet gjyqësore dhe veprimet kadastrale | 1 ditor | civile | IGJK/OSBE |
| | 29 | Ligji për ndërmjetësimin | 1 ditor | civile | IGJK/SEAD |
| | 30 | E drejta Evropiane në praktikë | 4 ditor | penale | IGJK/Twining |
| | 31 | Procedura e ekzekutimit | 1 ditor | civile | IGJK/SEAD |
| **Qershor** | 32 | Shpronësimi | 1 ditor | civile | IGJK/OSBE |
| | 33 | Zhvillimi i Shkathtësive të përf. Gjatë Gjykimit | 3 ditor | penale | IGJK/ US DOJ |
| | 34 | Procedura përgatitore për të Mitur | 1 ditor | penale | IGJK/UNICEF |
| | 35 | E drejta Evropiane në praktikë | 5 ditor | civile | IGJK/ Twining |
| | 36 | Kontrata për licencën, lizingun, magazinimin dhe kontrollimin e mallit | 1 ditor | civile | IGJK/SEAD |
| **Korrik** | 37 | E drejta Evropiane në praktikë | 5 ditor | penale | IGJK/ Twining |
| **Shator** | 38 | Dëshmitarët e mbrojtur | 1 ditor | penale | IGJK |
| | 39 | Konfiskimi i pasurisë të fituar me vepër penale | 1 ditor | penale | IGJK |
| | 40 | Standardet ndërkombëtare dhe Ligji për barazi gjinore | 1 ditor | specializura | IGJK/UNwomen |
| | 41 | Trafikimi i qenieve njerëzore | 1 ditor | specializura | IGJK/UNwomen |
| | 42 | Dhuna në familje | 1 ditor | specializura | IGJK/UNwomen |
| | 43 | Trafikimi i qenieve njerëzore | 1 ditor | specializura | IGJK/UNwomen |
| | 44 | Dhuna në familje | 1 ditor | specializura | IGJK/UNwomen |
| | 45 | Kontrata për kredinë | 1 ditor | civile | IGJK/SEAD |
| | 46 | Krimet e Luftës | 2 ditor | penale | IGJK/OSBE/ODHIR |
| | 47 | Standardet ndërkombëtare kundër dhunës në familje, Ligji kundër diskriminimit dhe çështjet pronësore | 1 ditor | civile | IGJK/CLARD |
| | 48 | Standardet ndërkombëtare kundër dhunës në familje, Ligji kundër diskriminimit dhe çështjet pronësore | 1 ditor | civile | IGJK/CLARD |
| | 49 | Praktika e dënimit | 1 ditor | Penale | IGJK/EULEX |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | 50 | Krimi Financiar dhe ekonomia jo formale | 1 ditor | penale | IGJK |
| **Tetor** | 51 | Korrupsioni | 1 ditor | penale | IGJK |
| | 52 | Arbitrazhi | 1 ditor | civile | IGJK/SEAD |
| | 53 | Ligji për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore | 1 ditor | civile | IGJK/OSBE |
| | 54 | Edrejta për një proces të rregullt (neni 6 i KEDNJ) | 1 ditor | KEDNJ | IGJK |
| | 55 | Ligji për mbrojtjen e mjedisit | 1 ditor | specializura | IGJK |
| | 56 | Standardet ndërkombëtare të përmbarimit civil | 1 ditor | civile | IGJK/SEAD |
| | 57 | Procedura Disiplinore pranë KGJK-së | 1 ditor | penale | IGJK |
| | 58 | Organizimi i Gjykatave sipas Ligjit të ri mbi Gjykata | 1 ditor | specializura | IGJK |
| | 59 | Ligji për prokurorinë e shtetit | 1 ditor | specializura | IGJK |
| | 60 | Arrestimi, ndalimi dhe paraburgimi i të miturve | 1 ditor | penale | IGJK |
| | 61 | E drejta evropiane në praktikë | 5 ditor | civile | IGJK/Twinning |
| | 62 | Zhvillimi i shkathtësive të përfaqësimit gjatë gjykimit | 3 ditor | specializura | IGJK/NITA |
| | 63 | Formulimi dhe mbështetja e grupeve konsultative jo formale të drejtësisë për të mitur | 1 ditore | Tryeza të diskutimeve | IGJK/UNICEF |
| | 64 | Formulimi dhe mbështetja e grupeve konsultative jo formale të drejtësisë për të mitur | 1 ditore | Tryeza të diskutimeve | IGJK/UNICEF |
| | 65 | Formulimi dhe mbështetja e grupeve konsultative jo formale të drejtësisë për të mitur | 1 ditore | Tryeza të diskutimeve | IGJK/UNICEF |
| | 66 | Formulimi dhe mbështetja e grupeve konsultative jo formale të drejtësisë për të mitur | 1 ditore | Tryeza të diskutimeve | IGJK/UNICEF |
| | 67 | Formulimi dhe mbështetja e grupeve konsultative jo formale të drejtësisë për të mitur | 1 ditore | Tryeza të diskutimeve | IGJK/UNICEF |
| | 68 | Skicimi i modulit të drejtësisë për të mitur | 1 ditore | Tryezë pune | IGJK/UNICEF |
| **Nëntor** | 69 | E drejta evropiane në praktikë | 5 ditor | penale | IGJK/Twinning |
| | 70 | Sjelljet e pahijshme dhe rastet specifike nga Praktika e zyrës së prokurorit publik | 1 ditor | penale | IGJK |
| | 71 | Lufta kundër krimit kibernetikë | 1 ditor | penale | IGJK/ Shoqata e Bankave të Kosovës |
| | 72 | Paraburgimi dhe Arsyetimi i vendimit | 1 ditor | penale | IGJK |
| | 73 | Ekzekutimi i masave dhe dënimeve ndaj të miturve | 1 ditor | penale | IGJK |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | 74 | E drejta për respektimin e jetës | 1 ditor | penale | IGJK |
| Dhjetor | 75 | Marrëveshja për pranimin e fajësisë | 1 ditor | penale | IGJK |
| | 76 | Kontrata për shitjen e mallrave sipas Konventës së OKB-së | 1 ditor | civile | IGJK/SEAD |
| | 77 | Procedura e shkurtër | 1 ditor | penale | IGJK |
| | 78 | Krimet e Urrejtjes | 1 ditor | penale | IGJK/OSBE/OD IHR |

## 19.2. Aneksi III – Aktivitetet e realizuara në PTA - 2011

| Muaji | Nr | Tema | Kohëzgjatja | Financimi |
|---|---|---|---|---|
| Janar | 1 | Konventa Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut | 1 ditore | IGJK |
| | 2 | Menaxhimi i rasteve | 1 ditore | IGJK& NCSC |
| Shkurt | 3 | Krimi i Organizuar | 2 ditore | IGJK |
| | 4 | E drejta e BE-së | 2 ditore | IGJK |
| | 5 | Kodi i Drejtësisë për të Mitur | 1 ditore | IGJK |
| Mars | 6 | Kodin penal dhe Kodi i Procedurës Penale | 2 ditore | IGJK |
| | 7 | Ndërtimi i Shkathtësive të Përfaqësimit gjatë Gjykimit | 3 ditore | US/DOJ&IGJK |
| | | Marrëveshja për Pranimin e Fajësisë | 2 ditore | IGJK |
| Prill | 9 | E Drejta Kushtetuese | 1 ditore | IGJK |
| Maj | 10 | E drejta civile materiale dhe procedurale | 1 ditore | IGJK |
| | 11 | Etika gjyqësore dhe prokuroriale | 1 ditore | IGJK |
| Qershor | 12 | Akti administrativ dhe konflikti administrative | 1 ditore | IGJK |
| Shtator | 13 | E drejta civile material dhe procedural | 1 ditore | IGJK |
| Tetor | 14 | Shkrimi dhe Arsyetimi Ligjor | 1 ditore | IGJK |
| | 15 | Marrëveshja për Pranimin e Fajësis, | 2 ditore | IGJK |
| | 16 | Ndërtimi i Shkathtësive të Përfaqësimit gjatë Gjykimit | 3 ditore | IGJK |

## 19.3. Aneksi IV – Aktivitetet e realizuara për gjyqtarët porotë - 2011

| Muaji | Nr | Tema | Kohëzgjatja | Regjioni | Financimi |
|---|---|---|---|---|---|
| **Qershor** | 1 | Trajnim i avancuar për gjyqtarët porotë | 1 ditore | Regjioni i Prishtinës, Gjilanit dhe Mitrovicës | IGJK |
| **Shtator** | 2 | Trajnim i avancuar për gjyqtarët porotë | 1 ditore | Regjioni i Prizrenit dhe Pejës | IGJK |

## 19.4. Aneksi V – Aktivitetet e realizuara për profesionist tjerë në sistemin e drejtësisë - 2011

| Muaji | Nr | Tema | Kohëzgjatja | Financimi |
|---|---|---|---|---|
| **Janar** | 1 | Hyrje në përmbarim | 1 ditore | IGJK& SEAD |
| | 2 | Komunikimi me shkrim | 1 ditore | IGJK& SEAD |
| | 3 | Kodi i etikës për zyrtarë përmbarimor | 1 ditore | IGJK& SEAD |
| **Shkurt** | 4 | Masat përmbarimore, pjesa e I | 1 ditore | IGJK& SEAD |
| | 5 | Masat përmbarimore, pjesa e II | 1 ditore | IGJK& SEAD |
| | 6 | Iniciativa për zvogëlimin e lëndëve të vjetra | 1 ditore | IGJK& SEAD |
| **Maj** | 7 | Krimet e Luftës | 1 ditore | IGJK & OSBE/ICTY-ODIHR |
| **Dhjetor** | 8 | Përmbarimi në sendet e paluajtshme dhe hipotekë, në llogaritë bankare dhe në të ardhura personale | 1 ditore | IGJK/SEAD |
| | 9 | Roli i bashkëpunëtorëve profesional në sistemin e drejtësisë | 1 ditore | IGJK |

## 19.5. Aneksi VI – Modulet trajnuese të realizuara me kandidatët për gjyqtarë dhe prokurorë gjatë vitit 2011

| Nr. i modulit | Emërtimi i Modulit |
|---|---|
| Moduli 1 | Kodi Penal (pjesa e përgjithshme) |
| Moduli 2 | Kodi i Procedurës Penale (pjesa 1-2) |
| Moduli 3 | KEDNJ-Legjislacioni për të Drejtat e Njeriut |
| Moduli 4 | Etika Profesionale për Gjyqtarë dhe Prokurorë |
| Moduli 5 | Kodi Penal (pjesa e veçantë) |
| Moduli 6 | Kodi i Procedurës Penale (pjesa 3 - 4) |
| Moduli 7 | Trafikimi me Njerëz |
| Moduli 8 | Hartimi, Arsyetimi dhe Hulumtimi Ligjor |
| Moduli 9 | Kodi i Procedurës Penale (pjesa 5–8) |
| Moduli 10 | Kodi i Drejtësisë për të Mitur |
| Moduli 11 | Krimi Financiar |
| Moduli 12 | E Drejta Kushtetuese dhe e Drejta Administrative |
| Moduli 13 | E Drejta Civile |
| Moduli 14 | Procedura Kontestimore – pjesa e parë |
| Moduli 15 | Procedura Kontestimore – pjesa e dytë |
| Moduli 16 | Procedura Jokontestimore dhe Përmbarimore |
| Moduli 17 | E Drejta e BE-së |
| Moduli 18 | E Drejta e Detyrimeve |
| Moduli 19 | E Drejta Familjare |
| Moduli 20 | E Drejta Ekonomike |

| | |
|---|---|
| Moduli 21 | E Drejta Pronësore |
| Moduli 22 | E Drejta e Trashëgimisë |
| Moduli 23 | E Drejta e Punës |
| Moduli 24 | Menaxhimi i Rasteve, Ndërmjetësimi dhe Rregullat e Komunikimit |
| Moduli 25 | Fillimi dhe Kohëzgjatja e Hetimit |
| Moduli 26 | Aktakuza |
| Moduli 27 | Roli dhe Funksioni i Prokurorit Publik sipas KPPK |
| Moduli 28 | I Pandehuri në Procedurë Penale |
| Moduli 29 | Masat e Fshehta dhe Teknike të Hetimit dhe Vëzhgimit |
| Moduli 30 | Masat për Sigurimin e Pranisë së të Pandehurit në Procedurë |
| Moduli 31 | Dëshmitarët në Procedurën Penale |
| Moduli 32 | Këqyrja në Vendngjarje dhe Forenzika |
| Moduli 33 | Procedura për Konfiskim |
| Moduli 34 | Përpilimi i Mjeteve Juridike nga Prokurori |
| Moduli 35 | Zhvillimi i Shkathtësive të Përfaqësimit gjatë Gjykimit |

## 20. Lista e shkurtesave

**IGJK**......................................................................................Instituti Gjyqësor i Kosovës
**PFAL**.........................................................................Programi Fillestar për Arsimim Ligjor
**PVAL**........................................................Programi i Vazhdueshëm për Arsimim Ligjor
**DD**...............................................................................Departamenti i Drejtësisë i SHBA-ve
**KPK**..........................................................................................Kodi i Penal i Kosovës
**KPPK**....................................................................Kodi i Procedurës Penale të Kosovës
**LPK**.......................................................................................Ligji i Procedurës Kontestimore
**LPJK**.................................................................................Ligji i Procedurës Jokontestimore
**LPP**.....................................................................................Ligji i Procedurës Përmbarimore
**LSKRR**.........................................................Ligji për Sigurinë e Komunikacionit Rrugor
**LRQP**......................................................................Ligji për Rendin dhe Qetësinë Publike
**US-DOJ**..........................Ambasada Amerikane, Departamenti i Drejtësisë së SHBA-ve
**OPDAT**.........Zyra Tejoqeanike për Zhvillim të Trajnimeve Profesionale për Prokurorë
**BE**..............................................................................................................Bashkimi Evropian
**UNDP**......................................................Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
**OSBE**...............................................Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian
**NCSC**............................................................Qendra Kombëtare për Gjykatat Shtetërore
**UNICEF**.................................Programi i Kombeve të Bashkuara për Fondin e Fëmijëve
**UNIFEM**..........................................................Programi për Zhvillim i Rrjetit të Gruas
**EULEX**...........................................Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit
**NITA**.....................................................Instituti Kombëtar për Përkrahje gjatë Gjykimit
**USAID**...................................................................................Ndihma nga Populli Amerikan
**Twinning Project EU-LER**..............Projekti i Binjakëzimit, financuar nga BE– Zyra e Komisionit Evropian në Prishtinë
**CLARD** ........................................ Qendra për Ndihmë Juridike dhe Zhvillim Regjional
**UP**..................................................................................................Universiteti i Prishtinës
**GTZ**.............................................................. Projekti për Reformë Ligjore në Prishtinë

Instituti Gjyqësor i Kosovës
Kosovski Institut za Pravosudje
Kosovo Judicial Institute

Rr. "Muharrem Fejza" p.n. | http://igjk.rks-gov.net